

**University for the Organizational Sciences
“Pjetër Budi”
Institute for the Studies - Prishtina**

LOGOS

No. 4 / 2011

Botuesi:

**University for the Organizational Sciences
"Pjetër Budi"
Institute for the Studies - Prishtina**

International editorial board

1. Prof. Dr. Ibish Mazreku (Kosovo)
2. Prof. Dr. Jusuf Fejza (Kosovo)
3. Prof. Dr. Vexhi Halili (Albania)
4. Prof. Dr. Zef GJETA (Albania)
5. Prof. Dr. Sreten Miladinovski (Macedonia)
6. Prof. Dr. Ivica Smilkovski (Macedonia)
7. Prof. Dr. Iliev Ilija (Bulgaria)
8. prof. Dr. Ivan Ionkov (Bulgaria)

Reviewer

Prof. Dr. Sofronija Miladinovski

Design

Halil Zabeli

Print

EUROPRINT-Prishtina

Tirazi

700

Efektiviteti dhe adaptimi i modelit integrativ të Risk - Menaxhimit

Hyrje

Kompanitë gjate aktivitetit te tyre krijojnë plane dhe caktojnë objektiva ne lidhje me arritjen e qëllimeve te tyre përmes caktimit te sakte te objektivave. Gjate afarizmit te kompanisë, kompania mund te ballafaqohet me rreziqe te ndryshme te cilat mund te cenojnë objektivat, misionin dhe vizionin e saj. Arritja e këtyre qëllimeve dhe objektivave kërkon apo është domosdoshmëri për te pasur një kornize apo infrastrukture komplete te rregulluara mire dhe e koordinuar mire te ERM brenda kompanisë.

Duke pare përvojat e vendeve ku kane pasur një rrugëtim ne aplikimin e metodave te risk menaxhmentit ne praktike ne industrinë e sigurimeve e shohim shume te domosdoshme përdorimin aplikimin e risk menaxhmentit si rruge drejte implementimit te risk menaxhmentit te ndërmarrjes (ERM) edhe ne industrinë e re te sigurimeve ne Kosove.

1. Efektiviteti dhe adaptimi i modelit.

Për të pasur me te qarte qëllimin e këtij punimi dhe qëllimin e krijimit te modelit adekuat për kompanitë ne nivelin e tanishëm i cili do te krijonte një baze te mirë për te avancuar mënyrat e menaxhimit me te mire te përgjithshëm dhe

menaxhimit me te mire te riskut do te mundohemi te sqarojmë disa çështje si ne vijim¹:

„Risku i referohet paqartësive te cilat rrethojnë ngjarjet dhe ndodhitë ne te ardhmen. Kjo shprehet me ndodhitë qe mund te ndodhin dhe qe mund te kenë impakt nga ngjarjet me potencial ndikimi ne objektivat e organizatës.”

„Risk Menaxhmenti është qasja sistematike për te krijuar drejtimin e duhur nen paqartësitë duke identifikuar, vlerësuar, kuptuar, vepruar dhe komunikuar çështjet te ndryshme te riskut”

„Risk Menaxhmenti i Integruar është proces i vazhdueshëm, proaktiv dhe sistematik për te kuptuar, menaxhuar, dhe komunikuar riskun nga perspektiva gjithëpërfshirëse e organizatës. Kjo ka te beje me marrjen e vendimeve strategjike te cilat ndikojnë ne arritjen e objektivave te përbashkëta te organizatës”.

Ndërsa nëpër shume libra hasen terminologji te ndryshme ne lidhje me Risk Menaxhmentin e Ndërmarrjes/ Kompanisë (Enterprise Risk Management) si p.sh. „ Menaxhimi Strategjik i Riskut” (Strategic Risk Management), „ Menaxhimi Holistik i Riskut” (Holistic Risk Management) apo „ Risk Menaxhmenti i Integruar” (Integrated Risk Management), ku këto koncepte janë te përafërsisht te njëjta apo si sinonime me Risk Menaxhmentin e Ndërmarrjes (ERM)²

Sipas CAS³ kane adoptuar definicionin adekuat ne lidhje me Risk Menaxhmentin e ndërmarrjes (ERM) dhe definohet si ne vijim :

“ Risk Menaxhmenti i Ndërmarrjes/ Kompanisë (ERM) është disipline sipas se cilës organizata ne çdo industri vlerëson, kontrollon, përdor, financon dhe

¹ Treasury Board of Canada secretariat, Integrated Risk management Implementation Guide fq 4

² Casualty Actuarial Society, Overview of Enterprise Risk Management, Enterprise risk management Committee, May 2003 , fq. 8

³ Committee on Enterprise Risk Management

monitoron rrisqet prej te gjitha burimeve me qellim te ngritjes se vlerave afatshkurtra dhe afatgjate te pronareve te saj (stakeholders)"

Me larte cekem definicionin nga CAS ndërsa me poshtë do te cekim definicionin e COSO⁴ i cili është si ne vijim „ *si proces i ndikuar nga entitetet si bordi i drejtoresve, menaxhmenti dhe personeli dhe i aplikuar ne krijimin e strategjise neper tere ndërmarrjen (kompaninë) dhe i dizajnuar te identifikojë ngjarjet potenciale te cilat mund te dëmtojnë entitetin (ndërmarrjen) si dhe te menaxhoje rrisqet te cilat janë ne kuadër te risqve te pranuar (appetite risk) si dhe te krijoje siguri te mjaftueshme ne lidhje me arritjen e qëllimeve te entitetit (ndërmarrjes)"⁵.*

Për te funksionalizuar një sistem adekuat te ERM procesi duhet te ketë parasysh disa elemente. Korniza e ERM duhet te bazohet ne zhvillimin e kornizës ne dy drejtime, e para si :

Hapat e Procesit e cila ka të bëjë me identifikimin e risqeve, analizimin dhe kuantifikimin e riskut, integrimin e risqeve, vlerësimin dhe prioritetizimin e risqeve, trajtimin dhe shfrytëzimi i risqeve deri te monitorimi dhe shqyrtimi i tyre.

Drejtimi tjetre ka te beje me identifikimin e llojeve te risqve si p.sh: risqet e mundshme (Hazard) , Financiar, operativ dhe strategjik etj. Ne vazhdimësi do te përshkruanim me detal ne lidhje me risqet e larte cekuar se secili çka përfshinë në vetvete :

Hazard Risqet - përfshinë te gjitha risqet si zjarri, dhe demet tjera te pronës, vërshimet, tërmeti, ndërprerja e biznesit demete nga përgjegjësitë etj.

Risqet Financiare – ka te beje me risqet si likuiditeti, inflacioni, vlerësimi i asetëve, shkalla e interesit, këmbimi i jashtëm etj.

⁴ Committee of Sponsoring Organizations of the Treadway Commission (COSO)

⁵ ERM working group of the Society of Actuaries Risk Management Section, Enterprise Risk Management Specialty Guide, May 2006, faqe 8

Risku operacional – ka te beje me te gjitha risqet si operacionet e biznesit si resurset humane, zhvillimi i produkteve, furnizimi i rrjetit, teknologjia informative, raportimi i brendshme si buxhetimi, planifikimi, tatimet, vlerësimi i investimeve, informatat mbi kontabilitetin etj

Risku Strategjik – dëmtimi i reputacionit, kërkesat e klienteles, inovacionet e ndryshme, trendët kulturore dhe sociale, rregullativa , trendët ekonomik dhe politike etj.

Duke u bazuar ne definicionet me larte te cekuar secila kompani duhet te ketë kornizën e vete ne lidhje me Risk menaxhmentin e Kompanisë (ERM) dhe ne kuadër te saj duhet te ketë te integruar kornizën apo sistemin e Risk Menaxhmentit te Integruar.

Krijimi i një infrastrukture te integruar te risk menaxhmentit te kompanisë (Integrated Enterprise Risk management – IERM) është një baze e forte për funksionimin dhe menaxhimin adekuat te kompanisë përballë sfidave dhe llojeve te ndryshme te risqeve .

Industria e sigurimeve ne kohe moderne bazohet shume ne risk menaxhmentin si shkence dhe praktike. Përvoja regjionale sidomos ne Kosove tregon qe kompanitë ende nuk e kane idenë për risk menaxhmentin bile edhe përdorimin standard apo klasik te risk menaxhmentit e lere me implementimin e tij ne kuadër te kompanisë. Aplikimi i metodologjive te risk menaxhmentit ne kompanitë kosovare duhet te jete prioritet i menaxhmenteve te kompanive me qellim te shfrytëzimit te risk menaxhmentit nga menaxhmentet e kompanive për një menaxhim me adekuat. Me poshtë do te prezantojmë rëndësinë e implementimit klasik te risk menaxhmentit dhe deri te kalimi ne një sistem me te avancuara dhe te integruar qe quhet si ERM (Enterprise Risk Management). Nga kjo shohim diferencat dhe kalimet nga një forme e organizimit te risk menaxhmentit deri te forma e integruar risk menaxhmentit ne nivel te kompanisë (ERM). Ne te njëjtën kohe shihen shikimet për çështje te ndryshme ne nivel te një strukture si te asaj te risk menaxhmentit

klasik, pastaj atij ne nivel te biznesit dhe ne fund te risk menaxhmentit te ndërmarrjes/kompanisë ku edhe është fokusi i ynë.


Duke u bazuar ne përvojat e kompanive te cilat aplikojnë risk menaxhmentin në kuadër te tyre vijmë ne përfundim qe ato aplikojnë risk menaxhment tradicional te cilat si qasje riskun e shohin si diçka negative ndërsa sipas qasjes se integruar te ERM risqet i shohin edhe gjera pozitive.

Risk menaxhmenti tradicional është i prirur apo i fokusuar ne menaxhimin e te papriturave nga asetet fizike dhe financiare ndërsa ERM menaxhon përveç me asetet e prekshme gjithashtu edhe me asetet e paprekshme ku me se miri e definojnë tabela e mëposhtme :

Risk Menaxhmenti	Risk menaxhmenti i biznesit	Risk menaxhmenti i Ndërmarrjes (ERM)
-------------------------	------------------------------------	---

Fokusi	Risku hazard dhe financiar dhe kontrolli i brendshme	Risqet e biznesit dhe kontrollat e brendshme dhe qasja risk për risk	Risqet e biznesit dhe kotrolla e brendshme marrja e portfolios se risqeve ne nivel te entitetit
Objektiva	Mbrojtja e vlerës se ndërmarrjes .	Mbrojtja e vlerës se ndërmarrjes	Mbrojtja dhe rritja e vlerës se Ndërmarrjes
Qëllimi	Thesari, sigurimi dhe përgjegjësia operative	Adekuatshmëria e menaxhereve te biznesit	Aplikimi neper kompani ne çdo nivel dhe njësi
Theksi	Financat dhe operacionet	Menaxhmenti	Krijuesit e strategjisë
Aplikimi	Selektimi i fushave te riskut, njësitë dhe proceset	Selektimi i fushave te riskut, njësite dhe proceset	Nga burimet dhe vlerat e tërësishme te ndërmarrjes

"Situata aktuale" kapacitetet	"Ardhmëria" Vizioni
-------------------------------	---------------------



Burimi : Guide to Enterprise Risk management, Protiviti, faqe 10

Duke parë përvojat e vendeve ku kanë pasur një rrugëtim në aplikimin e metodave të risk menaxhmentit në praktike në industrinë e sigurimeve e shohim shumë të domosdoshme përdorimin aplikimin e risk menaxhmentit si rrugë drejte implementimit të risk menaxhmentit të ndërmarrjes (ERM) edhe në industrinë e re të sigurimeve në Kosovë.

Kjo rrugë nuk do të jetë e lehtë për arsye sepse kërkon menaxhment të përgjegjshëm me njohuri në lidhje me risk menaxhmentin në përgjithësi si dhe kritere adekuate për të implementuar praktikën me të mira në botën e zhvilluar me kujdes të veçantë adoptimi i përvojave, standardeve dhe praktikave me të mira mjedisit dhe nivelit të zhvillimit të kësaj industrie.

2. Risk Menaxhmenti i Ndërmarrjes (ERM)

Kompanitë gjatë aktivitetit të tyre krijojnë plane dhe caktojnë objektiva në lidhje me arrijen e qëllimeve të tyre përmes caktimit të sakte të objektivave. Gjatë afarizmit të kompanisë, kompania mund të ballafaqohet me rreziqe të ndryshme të cilat mund të cenojnë objektivat, misionin dhe vizionin e saj. Arritja e këtyre qëllimeve dhe objektivave kërkon apo është domosdoshmëri për të pasur një kornizë apo infrastrukture komplete të rregulluara mirë dhe të koordinuar mirë të ERM brenda kompanisë. Funksionimi i mirë i ERM behet përmes katër kategorive të objektivave të saj siç janë : Strategjike, Operative, Raportimeve dhe Zbatueshmërisë (ligjore).

Strategjike – përmes kësaj kategorie kompania krijon vizionin dhe misionin e saj dhe dizajnon qëllimet me prioritetin më të lartë të saj

Operative – kjo kategori ka të bëjë me krijimin e mirëfillte dhe efikas të të gjitha operacioneve brenda kompanisë duke performuar drejtë arritjes së qëllimeve dhe sigurisë ndaj humbjeve të mundshme.

Raportimit- përmes kësaj kategorie krijohen modalitete adekuatë të raportimeve dhe krijohet baza e mirëfilltë e të dhënave

Zbatueshmërisë- kjo kategori ka të bëjë me harmonizimin e rregullatës së brendshme me të gjitha ligjet në fuqi si dhe veprimi i brendshëm i kompanisë në harmoni me këto ligje.

Të gjitha këto kategori në arritjen e këtyre objektivave arrihen edhe përmes aplikimit të tetë(8) komponentëve siç janë : Mjedisi i brendshëm, krijimi i objektivave, identifikimi i rreziqeve/ngjarjeve, vlerësimi i riskut, kontrolli i riskut, aktivitetet kontrolluese, komunikimi dhe informimi dhe monitorimi.

Mjedisi i brendshëm – ka të bëjë me organizatën, brendinë e saj, mënyra e menaxhimit, raportimit, vijat raportuese, stafi, kultura organizative, stili menaxherial etj.

Krijimi i objektivave- përmes këtij komponenti arrihen objektivat të cilat janë krijuar përmes misionit dhe vizionit të kompanisë. ERM përmes metodologjisë së funksionimit të vetë arrin të eliminojë të gjitha pengesat në lidhje me arritjen e objektivave.

Identifikimi i rreziqeve / ngjarjeve – kjo komponentë ka të bëjë me identifikimin e të gjitha ngjarjeve si të brendshme dhe jashtme dhe që kanë impakt në arritjen e objektivave të përcaktuara të kompanisë

Vlerësimi i riskut – pas identifikimit të ngjarjeve të cilat kanë impakt në arritjen e objektivave bëhet analiza dhe vlerësimi i këtyre risqeve dhe impakti i tyre në arritjen e objektivave. Strukturat menaxheriale përgatiten në lidhje me mundësinë e ndikimit të këtyre ngjarjeve.

Kontrolli i risqeve – pas analizave kompania dhe menaxhmenti i kompanisë marrin veprime adekuate në lidhje me mënjanimin, pranimin dhe e këtyre risqeve të cilat kanë impakt në arritjen e objektivave të kompanisë.

Aktivitetet kontrolluese – janë pjesë përbërëse e rregullative së brendshme në lidhje me përgjigjet e nevojshme duke krijuar standarde, politika dhe procedura adekuate.

Informimi dhe komunikimi – të gjitha këto aktivitetet duhet të transmetohen edhe në nivele të tjera me qëllim të informimit të ngjarjeve të cilat ndodhin. Secili staf i kompanisë duhet të jetë i informuar dhe të kuptojë rolin dhe përgjegjësitë në kuadër të kompanisë.

Monitorimi – kompania duhet të ketë instrumente të tilla për të monitoruar të gjitha këto aktiviteteve përmes kontrolleve të brendshme. Kjo ka impakt në lidhje me përmirësimin e vijave funksionale dhe përmirësimin e tyre në interes të biznesit të sigurtë të kompanisë.

3. Procesi i Risk Menaxhmentit të Ndërmarrjes (ERM)

ERM për të funksionuar në ndërmarrje apo kompani aktivitetin e sa e zhvillon në kuadër të disa fusha dhe ato janë :

1. Kontrolli i Riskut
2. Risk menaxhmenti strategjik
3. risk menaxhmenti katastrofik dhe
4. kultura e risk menaxhmentit

3.1. Kontrolli i Riskut

Kontrolli i riskut është proces ku në vete ngërthen disa faza apo aktivitetet dhe ato janë : identifikimi, monitorimi, limitimi, eliminimi, mënjanimi dhe transferimi i riskut. Ky proces ka të bëjë me të gjitha rreziqet e cilat janë pranuar nga kompania. Ky proces është shumë efektiv nëse është i aplikuar si proces në tërë entitetin apo kompaninë jo vetëm parcialisht në njësi të veçanta. Aplikimi në tërë strukturën e kompanisë është shumë me interes duke pasur parasysh që struktura e një kompanie është një entitet dhe si i tillë do të ballafaqohet me tërë sfidat që mund të vijnë në të ardhmen.

Kontrolli i riskut si proces kalon nëpër disa aktivitete të cilat e rumbullakojnë aktivitetin si tërësi. Kontrolli i riskut si proces ka këto aktivitete : Identifikimin e riskut, vlerësimin e riskut, monitorimin e riskut, limitimin e riskut, mënjanimin e riskut, transferimin e riskut.

Identifikimi i riskut- ky proces në vetvete ka të bëjë me performimin e risqeve poshtë-lartë apo lartë poshtë.

Vlerësimi i riskut – bazohet në informacionet dhe gjykimet e menaxhmentit në lidhje me elementet e ashpërsisë dhe shpeshhtësisë të risqeve. Në këtë fazë caktohen risqet me prioritet dhe për monitorimin e këtyre risqeve caktohen ndonjë person adekuat i kompanisë për të përcjellur në kontinuitet.

Monitorimi i riskut – përmes monitorimit dhe përcjelljes së risqeve caktohen risqet me prioritet si dhe krijohet baza e informatave në lidhje me këto monitorime si dhe krijohet një bazë qendrore e informative në tërësi në kompaninë për të gjitha risqet e pranuar.

Limitimi i risqeve- pas caktimit të risqeve me prioritet caktohen pikat e kontrollit të cilat shfrytëzohen me raportet e riskut si dhe në bazë të këtyre gjërave krijohet plani aksionale për limitimin e këtyre risqeve.

Mënjanimi i risqeve- behet përmes deizjimit të produkteve të ofruara, programeve investuese me të sigurt dhe krijimit të procedurave operative me efikasë.

Transferimi i Riskut – kjo behet kryesisht duke e transferuar riskun e marre tek risiguruesi sipas marrëveshjeve apo rast pas rasti. Planit për vlerat e mbajtura të sigurimit dhe niveli i cedimit të risqeve të caktuara behet varësisht nga politika dhe programi i risigurimit të kompanisë.

3.2. Risk Menaxhmenti Strategjik

Risk menaxhmenti strategjik është proces i cili është i lidhur me risqet e kompanisë d.m.th risqet e pranuar si dhe kapitalin për risk të kompanisë në zgjedhjet e tyre strategjike në të ardhmen e tyre. Risk menaxhmenti strategjik ka për qëllim primar optimizimin e rezultateve duke agjustura në vazhdimësi rezultatet e kompanisë me qëllim të një vlerësimi sa më real të saj.

Përmes këtij Procesi menaxhmentit strategjik vlerëson drejte kapitalin ekonomik të kompanisë në lidhje me mbulesën e obligimeve që do të rrjedhin në të ardhme si dhe bëjnë axhustimin e çmimeve të produkteve të kompanisë në aspektin e ofrimit të produkteve adekuate për klientelen e tyre pastaj është shumë me rëndësi buxhetimi për kapital etj.

3.3. Risk Menaxhmenti i Katastrofave

Kompania në agjendën e vetë parashikon edhe skenarët me të këqij që mund të ndodhi kompanisë gjatë afarizmit të saj. Në këtë dinamike të zhvillimit të bizneseve dhe ballafaqimit me situata të ndryshme jo të mira për kompani, atëherë kompanitë bëjnë plane të ndryshme se si të përballojnë këto situata përmes përpilimit të planeve

te emergjencave përmes përpilimi të planeve për rimëkëmbje. Këto plane janë në të shumtën e rasteve shumë të detajuara si kompania dhe stafi i saj duhet të përballojnë , menaxhojnë dhe tejkalojnë situata të ndryshme të palakmueshme. Shume here kompanitë bëjnë apo simulojnë situata të ndryshme për të trajnuar stafin e saj që në rast të ndodhjes varet prej situatave të tilla të ditëve se si të menaxhohet me se miri me pasoja sa më të vogla. Qëllimi i kompanisë është përballimi i këtyre situatave dhe tejkalimi i tyre deri në kalimin në normalitet të zhvillimit të biznesit apo aktiviteteve të përditshme. Në të shumtën e rasteve kompanitë bëjnë stres teste si forme për matjen e efikasitetit të kompanisë për tu përballuar me situata të pakëndshme për kompaninë , aktivitetin e saj etj.

3.4. Kultura e Risk Menaxhmentit

Përmes kulturës së përgjithshme përcaktohet edhe kultura e risk menaxhmentit. Në vetë kultura ndërthuren disa aktivitete si : Vlerësimi i riskut, praktikat me të mira, përkrahja, komunikimi, mbështetja etj.

Vlerësimi i riskut- ka të bëjë me identifikimin e riskut dhe matjen e tij në nivel të kompanisë.

Praktikat me të mira- ka për qëllim identifikimin e praktikave me të mira të risk menaxhmentit të cilat janë me interes për kompaninë si dhe aplikimi i tyre.

Përkrahja – ka të bëjë me involvimin e menaxhmentit të lartë si dhe stafit për të përkrahur procesin në tërësi të risk menaxhmentit.

Komunikimi – përmes komunikimit kompania do të jetë më transparente në njoftimin me tërë proceset e sidomos me procesin e risk menaxhmentit. Përmes komunikimit diskutohen apo bëhen të njohura të gjitha sukseset dhe dështimet e

kompanisë. Kjo formë praktikohet shumë që përmes shpalosjes së këtyre gjërave të eliminojë paqartësitë dhe të involvojë të tërë stafin në eliminimin e tyre.

Mbështetja – kompania në kontinuitet duhet të avancojë në zhvillimin e kulturës së përgjithshme të saj e në veçanti të asaj të risk menaxhmentit. Kompania në kontinuitet angazhon staf të ri pastaj mund të ofrojë mënyra të ndryshme të trajnimit për të avancuar apo për të përcjellur trendët që rrethojnë kompaninë.

Literatura

1. Treasury Board of Canada secretariat, Integrated Risk management Implementation Guide
2. Casualty Actuarial Society, Overview of Enterprise Risk Management, Enterprise risk management Committee, May 2003
3. Committee on Enterprise Risk Management
4. Committee of Sponsoring Organizations of the Treadway Commission (COSO)
5. ERM working group of the Society of Actuaries Risk Management Section, Enterprise Risk Management Specialty Guide, May 2006,
6. Guide to Enterprise Risk management, Protiviti,

Abstrakt

Dimensioni ekonomik i globalizmit ka përfshirë të gjithë vendet e botës, si ato të zhvilluara, në zhvillim, madje edhe vendet e pazhvilluara. Ky proces ka rezultuar me rënien e sistemit komunist me planifikim centralist. Barrierat tregtare kanë filluar të eliminohen. Ndërvarësia ekonomike ka krijuar edhe ndërvarësinë politike. Pjesë e këtij procesi, po bëhemi edhe ne. Proceset transformuese shoqërore kërkojnë mobilizim të faktorëve potencial. Në këtë punim me pak fjalë do të shtjellohet koncepti i politikës doganore si pjesë e politikës ekonomike të një shteti sovran, më vështrim të posaçëm në Republikën e Kosovës.

Fjalë kyçe: Politika doganore, sistemi doganor, sistemi ekonomik, liberalizimi i tregtisë.

Kuptim i Doganave dhe Sistemit Doganor

Liberalizimi gjithnjë më i madh i ekonomisë globale padyshim se kërkon, në njërin anë bashkërenditjen dhe harmonizimin e sistemeve dhe mekanizmave fiskal të vendeve të ndryshme dhe në anën tjetër ruajtjen e sovranitetit fiskal nacional, në përputhje me specifikat e caktuara të vendeve përkatëse⁶. Politika doganore si pjesë

⁶ Abdylmenaf Bexheti: "Financat Publike", Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë 2007, fq. 448

e sistemit fiskal të një vendi, ka një rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e eksportit.

Doganat duke marrë parasysh karakteristikat e tyre, paraqesin një lloj të veçantë të tatimeve indirekte.⁷ Për doganat mund të thuhet se janë instrument i sistemit fiskal të një vendi të caktuar.

Doganat janë të hyra monetare të shtetit. Paguhen më rastin e kalimit të mallit të caktuar përtej kufirit, përkatësisht kufirit doganor.⁸ Dogana paraqet një nga instrumentet themelore për mbrojtjen e ekonomive kombëtare nga konkurrenca e jashtme, pranuar nga ana e Marrëveshjes së Përgjithshme për Dogana dhe Tregti (General Agreement on Tariff and Trade – GATT).⁹

Si çdo formë tjetër e të hyrave publike edhe doganat duhet të rregullohen me dispozita ligjore. Andaj, pra, tërësinë e këtyre dispozitave e përbën sistemi doganor. Me këto dispozita juridike rregullohet statusi dhe të drejtat dhe obligimet e institucioneve doganore dhe subjekteve që marrin pjesë në procedurë doganore. Sistemi doganor përbëhet edhe prej instrumenteve dhe instituteve doganore që janë të lidhura në mes veti.

Mundë të thuhet se sistemi doganor është tërësi e instituteve dhe instrumenteve doganore, të cilat kanë lidhje të ngushta dhe marrëdhënie të ndërsjella ndërmjet tyre. Është pra rrumbullakim i instituteve dhe instrumenteve të parapërcaktuara me ligje autonome, të cilat ndikojnë në njëra tjetrën në mënyrë reciproke.¹⁰

Sistemi doganor si pjesë integrale e sistemit ekonomik të një vendi paraqet sovranitet doganor që partitë politike në pushtet krijojnë, përmbushin, ndryshojnë dhe anulojnë dispozita në sferën e mbrojtjes doganore të ekonomisë kombëtare gjatë

⁷ Sabri Kadriu, "Financimi Publik me Vështirësi të Posaçëm në Kosovë", fq 135.

⁸ Bozhidar Jelçiq, "Shkenca mbi Financat dhe e Drejta Financiare", fq 278.

⁹ Dr. Jovanka Biljanoska, "Sistemi Doganor", Botues Universiteti "Pjetër Budi", Prishtinë 2006, fq 15.

¹⁰ Ylber Rraçi, "Sistemi Doganor në Kosovë", Prishtinë, 2003, fq 15.

këmbimit të jashtëm tregtar me vendet e huaja. Burim themelor i së drejtës së sistemeve doganore të vendeve të ndryshme janë Kodi Doganor dhe Ligji për Tarifën Doganore, si dhe aktet e tjera nen ligjore të shumta që dalin nga to¹¹. Shikuar nga ky aspekt sistemi doganor është pjesë përbërëse edhe e sistemit të përgjithshëm juridik të një shteti sovran.

Nocioni i Politikës Doganore

Politika doganore si substitut i politikës dhe sistemit fiskal, është pjesë përbërëse e politikës ekonomike të një vendi të caktuar. Me politikën doganore nënkuptojmë tërësinë e metodave dhe të veprimeve të cilat shteti i ndërmerr për mbrojtjen e prodhimeve apo produkteve ekonomik të vendit nga konkurrenca ndërkombëtare, dhe krijimin e mundësive për një zhvillim ekonomik më të mirë. Bazë juridiko-kushtetuese me të cilën realizohet politika doganore e një vendi përkatës është Kushtetuta si akti më i lartë juridiko-politik, me të cilën hedhen parimet e përgjithshme të rregullimit juridik të një vendi. Pra, me Kushtetutë hedhën vetëm parimet e përgjithshme, ndërsa me dispozita ligjore përkatëse, rregullohet në mënyrë të detaizuar kjo materie. Neni 10 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh: "Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës"¹². Gjithashtu neni 119 i Kushtetutës parasheh: "Secili person është i obliguar të paguajë tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj"¹³. Pra, Kushtetuta i jep prerogativa Kuvendi të Republikës së Kosovës për Provimin e Ligjeve që e rregullojnë këtë sferë. Dispozitat ligjore që e rregullojnë këtë materie pothuaj në çdo vend janë: Kodi doganor, ligji mbi tarifën doganore, ligji mbi tregtinë e jashtme etj. Në Kosovë menjëherë pas përfundimit të luftës, njëra ndër sfidat e rimëkëmbjes ekonomike ishte edhe ndërtimi i administratës doganore e cila mungonte.

¹¹ Dr. Jovanka Biljanoska, "Sistemi Doganor", Botues Universiteti "Pjetër Budi", Prishtinë 2006, fq63

¹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës

¹³ Po aty

Më 3 shtator 1999, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, nxjerri rregulloren me numër 1999/3 mbi themelimin e Administratës Doganore dhe shërbimeve tjera përkatës lidhur me doganat, ku edhe u vendos një regjim i tregtisë së jashtme. Kjo nënkupton pavarësimin e administratës doganore nga administrata doganore e Jugosllavisë së mbetur.

Politika doganore mundë të jetë aktive dhe pasive:

Me politikën doganore aktive, shteti i motivon subjektet ekonomike prodhuese që të orientohen për eksportin e prodhimeve të tyre. Qëllimi i politikës doganore aktive është që të sigurohen tregje të jashtme, që do të ishte parakusht për investim të reja dhe për rritjen e produktivitetit të kapaciteteve ekzistuese ekonomike. Si masa me të cilat stimulohet eksporti, rëndom janë premittë, subvencionet dhe stimulimet e ndryshme, të cilat i ndanë shteti me rastin e realizimit të eksportit.¹⁴

Përveç këtyre masave shteti mundet dhe ndërmerr edhe veprime tjera siç janë: aplikimi i tarifës doganore 0% për produkte të cilat eksportohen, lirimi nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) pastaj lehtësira të ndryshme fiskale etj. E gjithë kjo bëhet në favor të nxitjes së eksportit, ku edhe do të ndikohet në përmirësimin e bilancit të pagesave me botën e jashtme.

Për ndryshim nga politika doganore aktive, përmes *politikës pasive doganore* duke aplikuar instrumente afatgjate synohet kufizimi i importit të mallrave. Masat të cilat i ndërmerr shteti në këtë kontekst janë: aplikimi i tarifave të larta doganore, pastaj aplikimi i barrierave sasiore siç janë kuotat, më qëllim të mbrojtjes së produkteve vendore nga konkurrenca e jashtme. Rast konkret kemi vendet e Unionit Evropian të cilat po i paraqesin pengesë mallrave të importuara nga Kina, në industrinë e tekstilit etj. Pastaj, si masa tjera mbrojtëse shteti mundë të përdor doganat retorzive, barrierat jo tarifore etj.

¹⁴ Ylber Rraci, "Sistemi Doganor në Kosovë", fq. 34 -35.

Qëllimi i politikës doganore pasive është ndalja apo zvogëlimi i importit, kjo bëhet për arsye se dëshirohet të mbrohen prodhuesit vendor nga konkurrenca ndërkombëtare, dhe në këtë mënyrë ndikohet edhe në balancën e bilancit tregtar.

Nëse do e merrim si shembull Kosovën e pas luftës, atëherë, do të ishte rast i mirë për studime shkencore. Dihet mirëfilli se ekonomia kosovare pas luftës ishte shkatërruar, dhe në këtë aspekt me politikën doganore nuk janë ndërmarrë kurrfarë masash me të cilat do të stimulohet eksporti, dhe të nxitet zhvillimi ekonomik. Arsyet duhet kërkuar në baza politike, kur dihet se deri me shpalljen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran, ky institucion i rëndësishëm ishte në kompetencë të shtyllës së katërt të UNMIK-ut.

Politika Doganore si shprehje e autonomisë së Shteteve Sovrane

Shteti me akte normative përcakton me saktësisht politikën dhe sistemin doganor.¹⁵ Politika doganore, në radhë të parë, është autonome dhe përcaktohet pavarësisht nga interesat e shteteve të tjera. Pra, ajo shpreh interesat e shtetit sovran.¹⁶

Pra, shtetet sovrane në mënyrë të pavarur miratojnë ligje me të cilat rregullohet materia e politikës dhe sistemit doganor. Në këtë kontekst para se gjithash mbetet kompetencë ekskluzive e shtetit sovran që të përcaktoj normat e tarifave doganore, pastaj masat të cilat i ndërmerr më qëllim të mbrojtjes së ekonomisë kombëtare nga invazioni tregtar ndërkombëtar. Në praktikë ndodhin raste kur një shtet i kundërpërgjigjet, shtetit tjetër me kundër masa, dhe në këtë mënyrë pengohet qarkullimi ndërkombëtarë i mallrave, kapitalit dhe shërbimeve. Me qëllim të evitimit të këtyre konflikteve, në botën bashkëkohore, sfera e tregtisë së jashtme po rregullohet me marrëveshje ndërkombëtare, për këtë arsye edhe në vitin 1945 është formuar **Marrëveshja e përgjithshme mbi doganat dhe tregtinë (GATT)** e cila që nga viti 1995 ka ndërruar formë dhe tani quhet **Organizata Botërore e Tregtisë (OBT)**, e cila si qëllim kryesor ka bashkëpunimin në sferën e tregtisë së jashtme.

¹⁵ Musa Limani, "Makroekonomia Aplikative", fq. 142.

¹⁶ Ylber Rraci, "Sistemi Doganor në Kosovë", fq. 34.

Politikat Doganore në Relacionet Ndërkombëtare

Marrëdhëniet ekonomike midis shteteve të ndryshme, me shkëmbim mallrash dhe shërbimesh, varen në mënyrë thelbësore nga ndërhyrja e sistemit fiskal, nëpërmjet aplikimit të tagrave doganore. Këto, siç është e njohur mund të vilen në çastin kur importohet një prodhim (tagër importimi), atëherë kur ai eksportohet (tagër eksporti) ose kur mallrat kapërcejnë territorin kombëtar (tagër kalimi). Në botën moderne verifikohen thujse vetëm tagrat e importit¹⁷.

Më lartë theksuam se politika doganore para se gjithash është kompetencë ekskluzive e shteteve sovrane. Megjithatë, në rrethanat bashkëkohore nuk mund të thuhet se politikat doganore autonome nuk ka edhe elemente të koncepteve të cilat i tejkalojnë kornizat e politikës doganore të shtetit përkatës. Përkundrazi, politika doganore autonome kushtëzohet edhe me elemente dhe koncepte të politikave doganore të shteteve të tjera. Kjo ndodhë në rastet kur shteti përkatës pranon, nënshkruan, e më vonë edhe i ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare bilaterale apo multilaterale mbi tregtinë e jashtme.¹⁸ Pasi që shtetet t'i nënshkruajnë dhe t'i ratifikojnë këto marrëveshje, bëhen pjesë e legjislacionit intern - kombëtar, nga të cilat dalin të drejta dhe detyrime. Shtetet nënshkruese janë të detyruara që me vetë fakti e nënshkrimit, edhe t'u përmbahen këtyre marrëveshjeve. Si marrëveshje ndërkombëtare multilaterale më të rëndësishme vlen të përmenden këto:

- **Konventa doganore mbi nomenklaturën e mallrave, e ashtuquajtur Nomenklatura e Brukselit;**
- **Konventa doganore mbi vlerën e mallit;**
- **Marrëveshja e përgjithshme mbi doganat dhe tregtinë (GATT);**
- **Organizata Botërore e Tregtisë etj.¹⁹**

¹⁷ Mario Leccisotti: *"Leksione të Shkencës së Financave"*, Elite 2000, fq.608

¹⁸ Ylber Rraci, "Sistemi Doganor në Kosovë", fq. 34.

¹⁹ Skender Berisha: "Ekonomia Ndërkombëtare", Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2002, fq. 205

Përveç këtyre marrëveshjeve kemi edhe marrëveshjen për themelimin e Tregut Unik Evropian, ku funksionon edhe Unioni Doganor. Marrëveshjet ndërkombëtare mbi tregtinë e jashtme, përveç që ndikojnë pozitivisht në nxitjen e tregtisë së jashtme, ato ndikojnë edhe në përmirësimin e marrëdhënieve politike, dhe janë në favor të integritimeve rajonale dhe globale.

Republika e Kosovës është nënshkruese e marrëveshjeve të tregtisë së lirë me disa prej vendeve të rajoni siç janë: Shqipëria, Maqedonia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina. Me hyrjen në fuqi të CEFTA-s, pjesë e së cilës është edhe Kosova, dalin të drejta dhe detyrime që janë në funksion të përmirësimit të rrjedhave të tregtisë së jashtme, eliminimit të barrierave doganore, dhe përgatitjen e këtyre vendeve për integrim në Unionin Evropian. Kjo marrëveshje në praktikë nuk po zbatohet në tërësi, për faktin se shtetet si Serbia dhe Bosnja e Hercegovina nuk i pranojnë mallrat me origjinë kosovare (mallrat me vulën e Republikës së Kosovës). Mendojmë se institucionet relevante duhet të përgjigjen me kundërmasa ndaj këtyre shteteve duke përdorur parimin e reciprocitetit.

Rëndësia e Politikës Doganore

Rëndësia e politikës doganore është e jashtëzakonshme për ekonominë kombëtare. Shteti duke aplikuar instrumentet e politikës doganore orientohet nga zgjidhjet afatgjata për sigurimin e kushteve për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Përmes analizave të mirëfillta ekonomike, shteti i orienton politikat e veta doganore në përputhje me prioritetet zhvillimore. Aplikimi i një instrumenti të caktuar doganor nga ana e shtetit bëhet konform kërkesave ekonomike relevante dhe me plan afatgjatë për zgjidhje permanente.

Nëpërmjet saj, shteti përkatës në mënyrë permanente orientohet në planin e mbrojtjes doganore, përkatësisht të importit dhe të eksportit të mallrave, në planin e arritjes së efekteve fiskale të detyrimeve doganore, duke parapërcaktuar normat e taksave doganore. Po kështu, me politikën doganore shteti përkatës angazhohet

edhe në planin e rregullimit të ofertës dhe të kërkesës, në planin e nivelit të çmimeve të prodhimeve në tregun e vendit etj.²⁰

Qëllimet e Politikës Doganore

Qëllimet e politikës doganore do të mundë t'i përmbledhë në tri më kryesoret të cilat janë:

- **Qëllimi fiskal,**
- **Qëllimi ekonomik dhe**
- **Qëllimi tregtar.**

Qëllimi fiskal i Politikës Doganore

Duhet vënë dukje menjëherë se është vështirë të gjykohet nëse një tagër ka natyrë fiskale apo mbrojtëse, sepse, me përjashtim të rasteve të veçanta, ai sjellë në të njëjtën kohë:

- 1.) shtimin e të hyrave fiskale;
- 2.) pakësimin e sasisë së importit,
- 3.) përmirësimin e bilancit të pagesave.²¹

Nga shkencat financiare është pranuar se doganat paraqesin një lloj tatimi, nga i cili shteti formon (krijon) mjete të konsiderueshme buxhetore.²² Pra, kur flasim për karakterin apo qëllimin fiskal të politikës doganore, mendojmë në ndërmarrjen e masave dhe të veprimeve të cilat shteti duke aplikuar tarifa doganore mbledh mjete

²⁰ Ylber Rraci, "Sistemi Doganor në Kosovë", fq. 35

²¹ Mario Leccisotti: "Leksione të Shkencës së Financave", Elite 2000, fq.608

²² Musa Limani, "Makroekonomia Aplikative", fq 142.

të konsiderueshme monetare për financimin e nevojave të përgjithshme dhe të përbashkëta.

Në fazën e tashme, në të cilën gjendet Kosova, mendojmë se politika doganore, ka pasur vetëm qëllimin fiskal. Në këtë aspekt ja ka arritur qëllimit, ku dihet se në strukturën e të hyrave publike në Kosovë, të hyrat nga aplikimi i tarifave doganore, marrin pjesë afër 60%, të totali të Buxhetit të Kosovës. Kjo shifër është indikator i cili flet për nivelin e zhvillimit ekonomik të vendit tonë. Ky indikator tregon edhe faktin se ekonomia jonë është e varur nga importi.

Qëllimi ekonomik i Politikës Doganore

Një nga qëllimet kryesore të politikës doganore është mbrojtja e prodhuesve të vendit dhe e ekonomisë në tërësi. Qëllimi ekonomik i doganave në shtetet e zhvilluara ekonomike bashkëkohore është qëllimi themelor që dëshirohet të arrihet me aplikimin e tyre. Karakteri mbrojtës i doganave qëndron në faktin se aplikimi i doganave përkatëse mundësohet dhe sigurohet prodhimi i produkteve përkatëse dhe përparohet zhvillimi ekonomik.²³

Shteti duhet të ndërmarrë ashpër politike doganore me të cilën pengohet importimi i mallrave të lira, në mënyrë që të mos u bëjë konkurrencë prodhuesve vendorë. Një kujdes i posaçëm duhet kushtuar mbrojtjes së produkteve bujqësore. Kjo arrihet duke aplikuar tarifa më të larta doganore për produktet bujqësore të cilat importohen. Për dallim nga vendet e zhvilluara të cilat aplikojnë politikë doganore, të karakterit ekonomik, vendet jo mjaft të zhvilluara dhe ato në tranzicion, fokusohen në mbledhjen e mjeteve monetare për mbushjen e arkës shtetërore (qëllimi fiskal). Nëse e studiojmë situatën ekonomike të Kosovës atëherë me rastin e aplikimit të tarifave doganore, mendojmë se shteti i Kosovës edhe përkundër faktit se është pjesë e Marrëveshjes për Tregti të Lirë CEFTA, duhet marrë parasysh edhe efektet dhe situatën ekonomike në të cilën është vendi ynë. Sidomos, duhet pasur

²³ Bozhidar Jelçiç, "Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare", fq. 286.

kujdes në sektorin e bujqësisë, ku konsiderojmë se gjatë sezone verore, këto produkte duhet të kenë tretman të veçantë dhe të mbrohen me masa të ndryshme doganore

Qëllimi Tregtar

Krahas qëllimeve fiskale dhe ekonomike, me politikën doganore realizohen edhe qëllimet tjera. Tregtia e jashtme është faktor i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi. Për këtë arsye shteti duhet të ndërmarrë masa të ndryshme për të ngritur eksportin. Po përmendim disa: aplikimi i tarifave doganore 0% për produktet të cilat eksportohen; lehtësirat e ndryshme fiskale brenda shtetit; aplikimi i doganave anti-damping etj. Në mënyrë që tregtia e jashtme të zhvillohet pa pengesa është e domosdoshme të lidhen marrëveshje bilaterale dhe multilaterale në mes vendeve dhe rajoneve të ndryshme. Formimi i unioneve doganore në rrafshin rajonal ndikon në përgatitjen e këtyre vendeve për integrimi globale.

Arsyeja pse shtetet ndërmarrin masa për ta nxitur eksportin, qëndron në faktin se përmes eksportit ndikohet në zhvillimin ekonomik dhe në bilancin tregtar me botën e jashtme.

Nëse e analizojmë situatën ekonomike në vendin tonë, shohim se kemi deficit të madh tregtar, çka nënkupton se ne eksportojmë para kesh në shtetet tjera, dhe më këtë krijojmë deficit të madh të parave të gatshme në vendin. Kjo situatë ka efekte të dëmshme ekonomike. Për këtë arsye edhe tentohet bilanci i tregtisë me Botën e Jashtme.

Politika Doganore në Republikën e Kosovës

Në Kosovë deri me sot nuk është përpiluar një politikë doganore afatgjatë. Është aplikuar një politikë doganore ad-hoc. Kjo ndoshta ka qenë edhe rrjedhim i

rrethanave aktuale në Kosovë, ngase nuk ka ekzistuar as politika ekonomike përkatëse. Në realitetin e krijuar në Kosovë, që në fillim UNMIK-u është angazhuar për një politikë doganore e cila do të jetë në harmoni me rrethanat aktuale në Kosovë, të mbështetur në koncepte bashkëkohore, duke mos i anashkaluar objektivat të cilat dalin nga konventat ndërkombëtare.³⁴

Politika doganore e aplikuar nga UNMIK-u ndryshon shumë nga politika doganore e vendeve në rajon. UNMIK-u nuk ka aplikuar politikë doganore për mbrojtjen e prodhimeve vendore siç kanë vepruar vendet e rajonit. Kjo ishte e arsyeshme fillimisht, ngase në Kosovë ishte shkatërruar çdo pore e jetës shoqërore dhe institucionale e më këtë edhe ekonomia. Për mallrat e importuara aplikohet vetëm taksa doganore, përballë vendeve të tjera ballkanike në të cilat për mallrat nga importi aplikohen edhe lloje të tjera të taksave.

Edhe përkundër faktit se sfera e doganave rregullohet dhe mbështetet në konventat ndërkombëtare, ajo nuk mundë të jetë peng i politikave doganore të vendeve për rreth. Parimi i reciprocitetit në marrëdhëniet ndërkombëtare tregtare duhet të gjejë zbatim të gjerë dhe është i domosdoshëm sidomos në raport me vendet fqinjë me të cilat kufizohet Kosova. Këtë e themi duke u mbështetur në faktin se shtetet fqinjë, në raportet tregtare me Kosovën aplikojnë masa diskriminuuese, të cilat bien ndesh me parimin e reciprocitetit dhe konventat ndërkombëtare.

Në politikën doganore që aplikoj UNMIK-u, ishin në zbatim konventat ndërkombëtare që kanë të bëjnë me tregtinë e jashtme. Duke i përfillur konventat ndërkombëtare, në politikën doganore të UNMIK-ut eliminohen pengesat për qarkullimin e lirë të mallrave me botën, të vëna për shkaqe politike, fiskale apo për interesa tjera. Veçanërisht në politikën doganore të UNMIK-ut, gjejnë zbatim rregullat të cilat i ka përcaktuar Organizata Botërore e Tregtisë.

³⁴ Ylber Rraci, "Sistemi Doganor në Kosovë", fq. 36.

Përkundër punës së madhe që ka bërë UNMIK-u në zbatimin e një politike doganore bashkëkohore, janë evidentuar dhe paraqitur një varg të metash. Këto mangësi kanë nxitur pakënaqësi tek institucionet kosovare dhe tek popullata vendore, dhe te komuniteti i biznesit. Për këtë arsye mendojmë se duhet bërë fjalë shkurtimisht (për shkak të karakterit të punimit) për anët pozitive dhe negative të politikës doganore të aplikuar nga UNMIK-u.

Anët Pozitive – në elaborimin tonë të deritanishëm kemi përmendur shumë aspekte pozitive të politikës doganore të aplikuar nga UNMIK-u. Për këtë arsye edhe nuk do të zgjerohemi shumë, por, po i përmendim vetëm disa pika më kryesore që e karakterizojnë këtë aspekt.

Me aplikimin e tarifave apo taksave doganore, janë mbledhur mjete të konsiderueshme monetare, me çka është plotësuar buxheti i konsoliduar i Kosovës. Për këtë fakt flasim të dhënat statistikore të Shërbimit Doganor, dhe të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Të hyrat nga aplikimi i tarifave doganore, pra, në strukturën e të hyrave në Kosovë marrin pjesë me afër 60%. Kjo shifër është alarmante, kur dihet se në vendet e UE-së, të hyrat nga doganat marrin pjesë me përqindje simbolike: 0,1%; 0,2% etj. Me fjalë të tjera politika doganore e UNMIK-ut ka pasur vetëm karakter fiskal, dhe nuk janë marrë parasysh komponentët tjera si: ekonomike, tregtare, sociale etj.

Anët Negative – krahas rezultateve të arritura për mbledhjen dhe sigurimin e mjeteve për buxhetin e konsoliduar të Kosovës, politikat doganore në kompetencë të së cilës ishte UNMIK-u, ka paraqitur edhe mangësi dhe zgjidhje jo të favorshme për ekonominë kombëtare. Këto mangësi po i paraqesim në vazhdim:

1. aplikimi i normës unike (lineare) të taksës doganore sipas normës prej 10% nga vlera e mallit, krahas përparësive, shumë shpejtë u bë pengesë dhe zuri të ndikoj negativisht në aktivizimin e kapaciteteve prodhuese. Kjo u bë për

shkak se kjo tarifë lineare e taksës doganore aplikohet në importin e të gjitha mallrave. Aplikohet në mënyrë lineare si për importin e pajisjes të destinuar për prodhim, të pjesëve të ndërrimit, të lëndës së parë, të materialit riprodhues, ashtu edhe për importimin e mallrave të konsumit të gjerë. Kjo ishte zgjidhje e gabueshme dhe prodhuesit vendorë erdhën në situatë të palakueshme me rastin e tentimit për aktivizimin e kapaciteteve prodhuese ekonomike.²⁵ Aplikimi i kësaj takse doganore u bë pengesë për investimet e huaja të drejtpërdrejta. Në çdo vend pajisjet e destinuara për prodhim lënda e parë, materiali riprodhues nuk kanë përqindje të njëjta doganore ose në tërësi lirohen nga obligimet doganore. Po të liroheshin këto produkte nga taksat doganore do të ndikonin që në masë të ngritën forcat prodhuese.

2. trajtimi preferencial i ish-republikës jugosllave të Maqedonisë (me tej IRJM). Mbetja në fuqi e marrëveshjes mbi njohjen e regjimit preferencial tregtar midis ish RFJ-së dhe IRJM-së sipas të cilës mallrat që e kanë origjinën nga ky vend nuk paguajnë tarifë doganore por paguajnë një tarifë administrative prej 1%, ka krijuar pabarazi tek importuesit e vendit.²⁶ Kjo marrëveshje ka bërë që shpesh të falsifikohen certifikatat e origjinës së mallrave. Kjo marrëveshje i solli dëme të pakontestueshme Kosovës.
3. gabim tjetër i madh në politikën doganore të UNMIK-ut, ishte mos aplikimi i taksës doganore për mallrat me origjinë nga ish Jugosllavia e mbetur. Me 18 shtator të vitit 2000 Komisioni Evropian e ka njohur Kosovën si territor të pavarur doganor për mallrat me origjinë kosovare. Andaj, na duket e çuditshme se pse UNMIK-u nuk e respektoi këtë vendim të Komisionit Evropian. Kështu duke mos caktuar pika doganore në kufi me Serbinë është krijuar mundësia për evazion fiskal dhe kontrabandë.
4. akcizat si taksa specifike, aplikohen për prodhime të veçanta vendore dhe për ato nga importi. Nuk është kontestuese se ato janë taksa të cilat e ngritin çmimin e mallrave të konsumit të gjerë. Qëllimi i tyre është që të rriten të

²⁵ Po aty, fq 38.

²⁶ RIINVEST, "Disa çështje të ndërtimit dhe zbatimit të politikës fiskale në Kosovë".

hyrat në buxhetin e shtetit.²⁷ Fillimisht me rregulloren mbi akcizat ishte paraparë të paguhen akcizat në vlerë. Kjo bëri që importuesit të mos deklarojnë me saktësi vlerën e faturave, pastaj u deshtë që akcizat në vlerë të zëvendësohen me akcizat specifike.²⁸ Kjo u dëshmuua se ishte zgjidhje e mirë dhe sjelli të hyra të konsiderueshme buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Akcizat specifike janë aplikuar edhe ndaj mallrave që nuk konsiderohen tradicionale. Aplikimi i kësaj takse doganore ka pasur edhe kund efekte, dhe i ka nxitë importuesit të gjejnë mënyra për t'ju shmangur detyrimit të pagimit të akcizave.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, institucionet vendore kanë bërë hapa pozitiv në zhvillimin e politikës doganore si: lirimi nga pagesa e taksës doganore për pajisje, lëndë të para etj., mirëpo mendojmë se duhet bërë edhe shumë ndryshime pozitive në funksion të qëllimeve të përgjithshme ekonomike në vend.

Kodi Doganor dhe i Akcizës i Republikës së Kosovës

Kodi Doganor dhe i Akcizës së bashku me TARIK-un (Tarifa e Integruar e Kosovës) përbën legjislacionin bazik të funksionimit të Doganave të Kosovës.²⁹ Deri me aprovimin e tyre nga Kuvendi i Kosovës, të drejtat dhe obligimet e subjekteve kane qene të shpërndara neper shume Rregullore të UNMIK – ut të sjella në kohe të ndryshme, tani shumica e tyre janë përmbledhur dhe janë inkorporuar në Kodin e Doganave dhe Akcizës. Me miratimin e këtyre akteve normative fushë – veprimtaria e Doganave deri diku unifikohet, dhe në këtë mënyrë u krijua mundësia ligjore që ky institucion respektibil të plotësoj kushtet themelore për fillimin e procesit të liberalizimit të vizave me vendet e Unionit Evropian ashtu siç kërkohet nga Komisioni Evropian, si dhe përgatitjen për Integritime Evropiane.

²⁷ Ylber Rraci, "Sistemi Doganor në Kosovë", fq. 46.

²⁸ Po aty.

²⁹ Kodi Doganor dhe i Kcizave, Nr. 03/L-109

Kodi Doganor dhe i Akcizës është zhvilluar duke inkorporuar principet bazike për modernizimin e Administratës doganore prej WCO Konventës ndërkombëtare të njohur si konventa e Kjotos dhe Marrëveshja e përgjithshëm për tarifa dhe tregti të njohur si GATT. Kodi i doganave dhe Akcizës krijon kushtet për zhvillimin të bizneseve dhe investimeve, gjithashtu ka për qëllim mbrojtjen e Ekonomisë në Republikën e Kosovës pa krijuar barriera shtesë administrative.³⁰

Përfundime

Politika doganore gëzon një rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik dhe të rritjes së tregtisë së jashtme, veçojmë disa përfundime si vijon:

- I domosdoshëm është edhe krijimi i bazës juridike për angazhimin e kapitalit të huaj në Kosovë, me lehtësira doganore që do të kontribuonin ngritjes së biznesit të vogël dhe të mesëm, në radhë të parë;
- Me rastin e caktimit të politikës doganore roli fiskal nuk duhet të jetë objektiv i vetëm për sistemin doganor. Autoritetet relevante kompetente në Kosovë duhet të ndërtojnë një politikë doganore që do të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik më të shpejtë;
- Duhet fokusuar në ngritjen e kapaciteteve prodhuese në vend, duke prodhuar mallra të zëvendësohet eksporti i mallrave dhe shërbimeve me prodhimet vendore, kështu edhe uljet deficitit të madh tregtar;
- Gjithashtu duhet të merren parasysh edhe trendët ndërkombëtare, sepse, Kosova nuk mund dhe nuk duhet të mbetet mbrapa vendeve për rreth. Vetëm me koncepte të qarta dhe me zgjidhje ligjore adekuate në rrethanat aktuale, në të cilat nuk do të anashkalohen veçoritë kosovare, politika doganore do të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

³⁰ <http://www.dogana-ks.org/repository/docs/kodi%20doganor%20shkurtimisht.pdf>

Bibliografia

1. Abdylmenaf Bexheti: *"Financat Publike"*, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë 2007
2. Bozhidar Jelçiç, *"Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare"*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, Prishtinë, 1983.
3. Jovanka Biljanoska, *"Sistemi Doganor"*, Botues Universiteti "Pjetër Budi", Prishtinë 2006
4. Mario Leccisotti: *"Leksione të Shkencës së Financave"*, Elite 2000, fq.608
5. Musa Limani, *"Makroekonomia Aplikative"*, Prishtinë, 2003.
6. RIINVEST, *"Disa çështje të ndërtimit dhe zbatimit të politikës fiskale në Kosovë"*, 14, shkurt 2002, Prishtinë.
7. Sabri Kadriu, *"Financimi Publik me vështrim të posaçëm në Kosovë"*, Sabrico, Prishtinë, 2002.
8. Skënder Berisha, *"Ekonomia Ndërkombëtare"*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2002;
9. Ylber Rraci, *"Sistemi Doganor në Kosovë"*, Grafika Reznici, Prishtinë, mars 2003.

Akte normative:

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
2. Kodi Nr. 03/L-109 DOGANOR DHE I AKCIZAVE NË KOSOVË;
3. Ligji për Aktivitetet e Tregtisë me Jashtme nr. 2002/6

I. Nocioni për kufirin shtetëror si kategori historike

Historia e njerëzimit është e njohur nga paraqitja e kufijve në mes fiseve, kulturave, civilizimeve. Në periudhën parahistorike mbisundonte „rregulla hyjnore” e gjithë toka është e krijuar nga njeriu dhe se ai lirshëm duhet ti përdor të mirat e saja”, për shkak se edhe vet njeriu është pjesë përbërëse e saj. Me paraqitjen e pronës përmes vendosjes së gardheve, prej këtu fillon kufizimi i sendeve në hapësirë, të grupeve të njerëzve me prejardhje të njëjtë, etnoset, kulturat dhe civilizimet.

Çka është kufiri si nocion, si praktik që nuk do të thotë vetëm hapësirë e rrethuar me shenja të paramenduar (shtylla prej betoni, guri etj) ose kufij të sjelljes së njerëzve në mes veti.

Në filozofi kufiri nënkupton kufizim të të gjitha sendeve në hapësirë, të një territori me pushtet të vet me ligje të veta dhe rregullim shoqëror, e krijuar nëpër rrjedhat historike të asaj shoqërie.

Historia universale e njerëzimit nuk është katalog enciklopedik të gjithë asaj që dihet për njerëzimin por për mundësi që të njoftohet me zhvillimin e përgjithshëm të shoqërive njerëzore. Ajo histori universale nuk është universale për gjithë popujt dhe kulturat të kufizuara përmes etnokufijve.

Sipas Platonit, shteti është kategori historike e paraqitur në kohë dhe hapësirë e cila ka cikël natyral të regjimeve. Nga ana tjetër, Aristoteli në librin e tij politika, shteti krijohet si rezultat i shkaqeve të caktuara prej revolucioneve, kur një regjim ndërrohet me tjerat dhe kështu me radhë gjerë sa ekziston ai shtet. Aristoteli ka pasur mendimin se asnjë regjim nuk mundet plotësisht ti plotëson nevojat e

shoqërisë dhe njeriut dhe se ajo pakënaqësi i shtyn njerëzit një regjim ta ndërrojnë me një tjetër në cikël të pakufishëm.

Demokracia nuk zë asnjë vend të posaçëm në at varg as me marrëdhënie të kualitetit as në marrëdhënie të stabilitetit në fakt, Platoni dhe Aristoteli përmendin se demokracia tregon tentim të largohet nga tirania. Ai ka besuar se cikli i regjimeve (pushteteve) është i instaluar në një cikël më të madh natyror në të cilën kataklizmet p.sh. Shkrirjet periodikisht do të shkatërrojnë shoqëritë ekzistuese njerëzore duke i detyruar njerëzit prej fillimit të fillojnë procesin historik në kufij të rij ose të vjetër, sipas kësaj filozofia përmes Platonit dhe Aristotelit historinë e kupton drejt si të pafund por e cila ka karakteristik ciklike.

Historitë e para universale për shtetet dhe shoqëritë në traditën perëndimore janë parimet krishtere të sjelljes si kolektivitet dhe si individ. Edhe pse ka pasur tendenca romake dhe greke që të shkruhen historitë e për shtetet dhe civilizimet, krishterimi i pari e vendon konceptin e barabarësisë të gjithë njerëzve në sytë e Zotit dhe prej aty edhe paraqitjen e fatit të përgjithshëm të gjithë popujve në vendet me kufijtë e tyre dhe civilizimet kulturore gjithashtu të rrethuara me kufij. Kështu p.sh. historiani krishterë, si Shën Augustini nuk është interesuar për historitë e posaçme të grekëve ose të hebrenjve si të tillë, por është interesuar për atë që ka qenë me rëndësi për shpëtimin e njeriut si njeri, diçka që do të thotë plotësim të dëshirës së Zotit në botë. Gjithë popujt janë vetëm degë të një njerëzimi të përgjithshëm fati i të cilëve mundë të kuptohet me planin e Zotit për njerëzimin. Në këtë kuptim, Krishterimi e jep kuptimin se historia dhe shtetet e kanë fundin në kohë, se fillon me krijimin e njeriut nga Zoti dhe mbaron me shpëtimin final të tij. Për Krishterët fundi i historisë së botës fillon me ditën e gjyqit të tmerrshëm i cili do të vendos njeriun në mbretërinë e amshueshme dhe prej atij momenti toka dhe ngjarjet tokësore do të përfundojnë së ekzistuari. Ngjarjet e veçanta historike mund të marrin kuptim vetëm në bazë të një rezultati ose qëllimi të përgjithshëm, arritja e të cilëve e mbaron procesin historik. Ripërtirja e interesit për antikën në periudhën e renesancës ka dhënë një horizont historik për mendimin. Krahasimi metaforik i

historisë njerëzore me jetën e një njeriu dhe idenë se njeriu modern i ndërtuar nga arritjet e të vjetërve jeton në „vjetërsinë e njerëzimit”.

Përparimin të cilin e paramendon Fontenel është para se gjithash në sferën e njohurive shkencore ai nuk ka zhvilluar teori adekuate për përparim shoqëror ose politik. Babai i kuptimit modern të përparimit shoqëror është Mekiaveli, për shkak se pikërisht ai ofron se politika duhet të jetë e lire prej mendimeve morale të filozofisë klasike dhe se njeriu vet duhet ta gjen rrugën kah zhvillimi i shoqërisë dhe shtetit. Të rëndësishme janë edhe teoritë e tjera për përparimin nga ana e mendimtarëve si p.sh. Volteri, Enciklopedistët francez, ekonomisti Turga dhe shoku i tij dhe biografi Kondorse. Përparimi i mendjes së njeriut prej Kondorse përmban një histori universale të njeriut me dhjetë periudha prej të cilave e fundit i cili ende nuk është arritur-karakterizohet me barabarësinë në mundësitë, liritë nacionaliteti, demokracinë dhe arsimin e përgjithshëm. Kondorsi si edhe Fontenel nuk kanë paramenduar fund të specializimit të njeriut me çka hapet mundësia për ndonjë...

Motivet Antropogjenë turistike te rajonit te Kumanovës dhe Likovës

Hyrje:

Turizmi si dukuri dhe lëvizje turistike si proces, sot paraqesin dukuri shoqërore ekonomike moderne dhe dinamike, e cila në fillim të periudhës industriale ishte privilegj e njerëzve të pasur, kurse sot paraqitet si nevojë për gjithë grupet sociale të shoqërive.

Ky regjion është karakteristik për disa vlera turistike natyrore dhe antropogjenë të cilët janë të llojllojshëm për nga përmbajtja e tyre atraktive. Motivet e ndryshme natyrore dhe antropogjen në këtë regjion rrjedhin prej kushteve dhe rrjedhave specifike natyrore dhe shoqërore-historike për një periudhë më të gjatë kohore.

Motivet natyrore paraqesin spektër të maleve,kodrave,kodrinave,mbetje vullkanike,lugina bimore, kanjone, fusha, burime, ujera termal dhe mineral, lumenjtë, liqene, male, kullosa etj. Gjithë këto objekte natyrore-gjeografik janë atraktiv jo vetëm për studimin e tyre por edhe për turistët dhe vizitorët.

Motivet turistike antropogjenë gjithashtu janë të shumtë, prej të cilëve do të ndahen arkitektura e re dhe e vjetër qytetare veshjet,zanatet dhe prodhimi, manastir, kisha, xhami, përmendore te ndryshme te reja dhe te vjetra,lokalitete arkeologjike, muzeu arkeologjik në Kumanovë etj.

1. Motivet turistike antropogjen

Regjioni i Kumanovës nga aspekti i motiveve turistike antropogjenë është karakteristik dhe të njëjtët mundë të diferencohen në këto grupe: tërësi ambientale në të cilën hynë qyteti i Kumanovës dhe lagjet rurale me specifikat e tyre,përmendoret kulturore-historike, muzetë dhe galeri dhe motive etnosociale.

1.1 Qyteti i Kumanovës si tërësi urbane

Qyteti i Kumanovës për herë të parë përmendet në shkrime në vitin 1519,bashkë me lagjet tjera në krahinën e Nagoricanit, me popullatë të përgjithshme prej 270 banorë. Kumanova si lagje fshatare, me vonë qyteze dhe qytet përmendet më shumë në dokumente të shekullit XVII, dhe emri rrjedh prej fisit Kumani me prejardhje turke. Emri i lagjes Kumanovë ka qenë i shënuar prej shumë udhërrëfyesve siç janë: Gjeografi turk haxhi Kalfa, Eduard Braun, Marin Kabata, Ami Beu dhe udhërrëfyesi turk Eulija Celebija.

Eulija Celebija cek se:qyteti i Kumanovës është i stolisur me shumë lumenj dhe 600 shtëpi të mbuluara me qeramidhe, xhamia e cila gjendet në çarshi është shumë e bukur. Ka teqe, medrese han, banja publike(hamam) numër të madh dyqanesh.

Udhërrëfyesi Ami Bue shkruan se Kumanova është qytetë me 3000 banorë me shumë bafce, të cilat ujiten dhe në të cilat janë prodhuar perime megjithatë rrugët nuk janë të pllakosura, të mbushura me pluhur, kurse muret janë prej qerpiçi dhe kashtë. Nga ana tjetër, udhërrëfyenin dhe hulumtuesi H.G Von Hon, ka evidentuar se rrethina e Kumanovës numëron 134 lagje se ky rajon paraqet drithore me kuptimin e plote të fjalës, vend dominant në tregtinë janë dhentë dhe leshti.

Gjithashtu emri i këtij qyteti përmendet edhe në hartat e Konteli (1689), Detil (1707), Hasius (1744), Anvie (1750) dhe Ruch (1770), kurse gjatë shekullit të XIX ka qenë nëpër të gjitha hartat gjeografike.

Më 1921 në qytetin e Kumanovës kanë qenë të evidentuar 16120 banorë. Pas luftës së II botërore lëvizjet e popullatës evidentojnë rritje të vazhdueshme.

Kështu p.sh. në periudhën prej 1948-2002 numri i popullatës në qytet është rritur prej 20242 në 76274 banorë ose për 276,8%

Në gjysmën e parë të shekullit XX, qyteti i Kumanovës ka pasur zhvillim ekonomikë intensiv me çka ka ndikuar në shkallën e centralitetit të popullatës prej lagjeve përreth prej regjionit të Kumanovës dhe me gjerë. Duhet të ceket se popullata prej pjesëve kodrinore-molare se prej Karadakut gjithashtu edhe Sredorekit, në periudhën e industrializimit (1965-1981), popullata fshatare koncentrohet në pjesët periferike të Kumanovës me çka u krijuan lagje substandarte periferike.

Periudha e pasluftës për qytetin e Kumanovës paraqet epokë të vjetër në zhvillimin e saj ekonomike-shoqëror. Objektet e shumta industrial (industria ushqimore, metalike, mullit, e mishit, tekstile e duhanit etj) mundësuan rritjen e centralizimit të popullatës fshatare por për fat të keq në periudhën e pluralizmit, të njëjtët kanë mbetur më shumë muze të kohës së kaluar. Sistemi pluralist i shoqërisë nuk u gjend pa dhimbje të transferuan ato industri me qëllim që ti vendon në proces të prodhimit.

Kumanova disponon me restorant të shumta, qendra tregtare, muzetë, biblioteka, objekte administrative, terrene sportive, qendra rekreative.

2. Lokalitete arkeologjike

Rajoni turistik i Kumanovës dhe Likovës është karakteristik me lokalitetet e shumta arkeologjike qysh prej periudhës antike. Kështu p.sh. në lokalitetin „Amam” në fshatin Llopat janë gjetur statuja të glinës së pjekur prej neolitit të vonshëm, pastaj gërmimet e mitreniumit në fshatin Bellanoc janë gjetur ikona reliefike prej guri, lokaliteti „Groble” në fshatin Vojnik lokaliteti „Pribove” në Bedinjë, „Drezga” ne Llopat „Breg” dhe „Kodra e Zulfis” në Nikushtak, „Gradishte” në Pelincë,të „Kodra” në Likovë,janë gjetur skelet prej periudhës së dardanëve, në të cilën janë ndeshur dy kultura më të mëdha: kultura Maqedone dhe kultura Dardane.

Me rëndësi është të ceket se mes këtyre lokaliteteve më interesat është lokaliteti „Amam” në Llopat në të cilën ndeshen elementet e kompleksit „Kosova”-jugomarovës dhe kompleksi anzabeg-Vrinik, shumë sende të cilat janë gjetur në regjionin e Kumanovës me vjetërsi të neolitit më të ri kanë ngjashmëri me ato që janë gjetur në Kosovë

Periudha e kohës së bronzit,e cila përfshin periudhën prej mileniumit të III deri në gjysmën e dytë të mileniumit të II, është karakteristike me lidhjen e ngushtë të kulturave të cilat janë zhvilluar në hapësirën të gjerë të Mavrovës jugore dhe Vardarit. Për këtë periudhë ekzistojnë materiale prej qeramike të cilat janë gjetur në lokalitetin „Gradina” dhe „Pribove” me vone qeramika të tilla janë gjetur edhe në lokalitetin „Gradishte” ne Pelince. Megjithatë duhet cekur se koha e hekurit 1300-III shekull para erës së re, e gjer te procesi i helenizimit, këtyre hapësirave ndihet përzierje e kulturave dhe civilizimeve. Prej kësaj periudhe janë gjetur enë prej qeramike dhe sende prej bronzit,tek lokaliteti „Groble” në fshatin Vojnik. Në periudhën e quajtur koha e hekurit II (700 vjet para erës së re) vjen deri te formimi i poleoballkanike, me çka vjen dhe periudha e përpunimit të bronzit dhe qeramikës në mënyrë me kualitative. Këtë e tregojnë edhe sendet e gjetura në afërsi të Banjës së

Kumanovës. Në këtë kohë paraqiten edhe lagjet e para në regjionin e Kumanovës dhe posaçërisht kanë qenë të ndërtuara në viset më të larta të kësaj hapësire.

Ultësira e lumit Pcinja qysh prej parahistorie, posaçërisht në kohën e periudhës historike kanë kaluar rrugë të rëndësishme përmes cilëve kanë qenë të lidhura qytezat e ndërtuara në lokalitetet „Mijacki rid“ (fshati Pcinja), „Grkvishte“ (fshati Studena Bara), pastaj „Crkvishte“ (fshati Orashac), „Broncevisa“ (në fshatin Stara Nagorican) janë gjendur mbeturina prej qeramike dhe krijime tjera të ndryshme të bëra me dorë të popullatës së atëhershme. Në regjionin e Kumanovës ekzistojnë bazaltë. Ato lokalitete janë të njohura me emra siç janë pllakat bazaltë Vujevska, Kastoperska dhe Karpa e qurqimt, Kula e Prkinit, Gust Kamen, këto lokalitete kanë qenë më të volitshëm për ngritjen e lagjeve qysh prej kohës së parahistorisë me kontinuitet të gjatë gjër te historia më e re. Kështu p.sh. në lokalitetin Kostoperska Karpa është e gjetur cisterna si dhe mbetje të bazilike (kisha) të mesjetës së hershme. Lagje e tillë me rëndësi me kontinuitet të gjatë është edhe opiumi „Glaucica“ mbi fshati Likovë. Në kohën e periudhës romake kjo lagje për shkak të rrethanave krejtësisht të tjera ka qenë e lëshuar në afërsi të fshatit Lopat rreth 7km në lindje. Dardanët u kanë dhënë probleme të mëdha perandorisë romake në këto hapësira. Okupimi përfundimtarë i Dardanisë prej Romakëve është bërë mes viteve 2-6 të erës së re, kështu që Dardania hyn në kornizat e provincës romake e quajtur Mezija e Epërme.

Në kohën e perandorisë Romake, në hapësirën e regjionit, fillon të re integrohen lagjet e përhershme të cilat kryesisht kanë qenë të locuara të visit më të larta, formohen edhe të reja me çka fillon procesi i re integritit të popullatës dhe bashkëpunim me i madh i vendbanimeve.

Interesante është të ceket se Glaucica në fshatin Likovë dhe „Kosto Perska Karpa“ fshati Stara Nagorican, në atë kohë kanë shërbyer si lagje në të cilën janë koncentruar popullata vendose duke ikur prej okupatoreve romak, por më vonë me liberalizimin e mundësive shoqërore-politike edhe këto lagje shkallë shkallë re

integrohen në doktrinën e sapo krijuar romake politiko shoqërore dhe rriten në lagje urbane me funksion regjionale.

Në lokalitetin „Drezga”(Lopat) ka qenë e vendosur në trekëndëshin mes, Mezise së Epërme(Dardanis), Trakisë dhe Maqedonisë, respektivisht në vendin ku kryqëzohen rrugët prej Scupi-Pantalija dhe Serdika. Në këtë periudhë janë zhvilluar edhe lagje tjera të cilat kanë pasur funksione me rëndësi, strategjike transite në periudhën romake siç janë: Bellanoc, Dabrashan, Orashac, Klecovc. Dovezence për çka konfirmojmë mbishkrime në gurë, qeramike etj. Mbetje prej Mitreumi në lloj i kanë reliefare prej guri në të cilën tregohet jeta e Zotit Mitra dhe Sall janë gjetur në fshatin Bellanoc, nëpër të cilin kalojnë rrugë tregtare të ndryshme të njohura deri në kohët më të vonshme me emrin rruga e Stambollit.

Ne kodrat e Karadakut Kumanovare për shkak të lidhjeve topografike dhe komunikative në Shkup kane qenë të formuar lagje në lagjet e tashme: Lopat, Opaj, Bedinje, Orizare, Hotel, Slupcan, Dumanoc, Belanoc, Likovë etj.

Me dobësimin e perandorisë Bizantine gjatë shekullit XIII regjioni i Kumanovës sikurse gjithë territori i Maqedonisë së sotme hyn nën sundimin Serb dhe Bullgar dhe atëherë është formuar: Zhegligovska zhupa, toka e djemve të Stefan Dushanit.

Në fushën e Kumanovës(zhegligane) armata turke kalon me 1389, nën udhëheqjen e Sulltan Muratit në rrugë për Fushë Kosovë.

Gjatë shekullit XVI regjioni i Kumanovës ka qenë Nahi me qendër në Nagarican në korniza të Kazës së Kratovës, respektivisht në përbërjen e Sanxhakut të Qustendilit. Me ardhjen e popullatës turke, në këto hapësira prapë ndodh ndryshim demografik të popullatës sipas përkatësisë etnike.

3. Përmendoret kulturore-historike si motive turistike

Përmendoret kulturore-historike paraqesin motiv turistik të rëndësishëm në rajonin e Kumanovës dhe Likovës. Në këtë hapësirë ekzistojnë shumë kisha, manastire, turbe, etj.

Në një periudhë të gjatë kohore në Kumanovë dhe hapësirën më të gjerë karakterizohet me xhami dhe kisha relativisht të vjetra, duke filluar prej shekullit të XI.

Sipas të dhënave të tanishme në regjionin e Kumanovës janë të regjistruara më shumë se 35 kisha dhe manastire, rreth 30 xhami, dhjetëra turbe, të stolisura me ikona me vlerë të madhe (kisha), dhe ndërtim i tyre interesant dhe arkitektura e tyre, kurse xhamitë në këto vise janë mjaft të vjetra, duke filluar qysh prej kohës kur këto vise kane rënë nën okupimin turk (xhamia e vjetër dhe tyrbja në gërmadha në fshatin Tabanovc), muzetë, arkivi historik i qytetit, përmendoret historike, observatoriumi Megolit Kokina mileniumi III para erës së re.

3.1 Kisha dhe manastire

Manastiri i Matecit gjendet në Karadakun e Likovës, në pjesën jugore të malit liqenor në lartësi mbidetare prej 1005m. Manastiri gjendet në një hapësirë të gjerë me ekspozitë lindore, prej nga lindja gjendet fusha e Matecit dhe qyteti i Kumanovës. Prej Kumanovës ky manastir është rreth 17.5 km, kurse prej fshatit të Likovës, është larg rreth 10.5 km, kurse prej Matecit 8 km. Manastiri i Matecit në 50 vitet e fundit ishte vendi i vetëm në këtë rreth për pushim, rekreacion dhe takime punuese.

Në kornizat e Manastirit të Matecit gjendet edhe kisha Shën Bogorodica, e cila paraqet objektin sakral me rëndësi në muret e së cilës janë vizatuar persona hyjnor prej jetës hyjnore Bizantine. Në pjesën jugore të murit janë vizatuar Car Uroshi me mbretëreshën Elena, pastaj portreti i mbret Dushanit, që do të thotë se kisha është

mjaft e vjetër dhe është e ndërtuar në fillim të shekullit XIV. Përveç këtyre fotove dhe portreteve, në muret e kësaj kishe janë të vendosura edhe shkrime (shkrim i Kiril Pjecinovicit gjatë vizitës së tij prej 1568, në kohën kur ka vdekur mitropoliti Nikolla. Megjithatë, kishte e përmendur në kohë të gjatë ishte nën gërmadha, kurse restaurimi i parë është bërë gjatë vitit 1934, pastaj më 1953 dhe 1960.

Kompleksi i manastirit të sotëm gjatë shekullit XV ishte qendër letrare në Maqedoni, për shkak se në këtë manastir kanë punuar edhe vepruar manaset Gerasim, Vlodislav Gramatik dhe Isai Domestik. Në bibliotekën manastirit të malit të shenjtë sh. Povle dhe në bibliotekën publike Sanktpeterzburg gjendet një dorëshkrim i rëndësishëm maqedon prej këtij manastiri. Gjithashtu, duhet të përmendet se manastiri dhe Literali Vladisov Gramatik në kohën e sundimit turk në këtë manastir e ka kaluar kohën më të madhe të jetës së tij. Gramatiku është i njohur edhe për atë se ka arritur në manastirin e Matecit ti përmbledh tre fjalorë: 1. Fjalorë prej 1469 ruhet në JANJY në Zagreb, i dyti fjalorë Andrijanti prej 1473, kurse i fundit Rilski prej vitit 1479 ruhet në bibliotekën e manastirit të Rililit. Më i rëndësishëm është fjalori i tret Andrijanti prej shekullit të X, për shkak se në këtë fjalorë janë zbuluar pjesë të muzikës kishtare maqedone me të cilën janë shërbyer manaset në këtë manastir.

Freskat në këtë manastir nuk janë të kualitetit të lartë.

Në kohën e konfliktit gjatë vitit 2001, janë rinovuar disa pjesë kurse ende nuk janë rinovuar hapësirat drejtuese të manastirit. Ekziston projekt i kompletuar për renovimin dhe dekorimin me gjithë objektet qëruese për shkak se ky kompleks turistik, për popullatën në këto vise pa marrë parasysh strukturën e tyre etnike të popullatës lyej jo vetëm profil, por edhe afrim të vizitorëve, mysafirëve prej hapësirave më të gjëra, kurse posaçërisht është e rëndësishme të vazhdon tradita e kaluar për rekreacion të rinis shkollore, studentëve, hulumtuesve etj.

Restaurimi i plotë i kompleksit të manastirit me gjithë objektet shoqëruese, ka nevojë edhe për ndërtimin e infrastrukturës: Central moderne telefonike, zgjerimin

dhe asfaltimin e rrugës prej Matecit deri te manastiri,ruajtje e vegjetacionit në hapësirën më të gjerë të manastirit etj.

Kisha „Sveta Petka” në Nagarican të ri është ndërtuar në gjysmën e parë të shekullit XVII (1628). Reth kishës ndodhen varreza të shumta, por prej këtu është si mbrojtës i të vdekurve. Kisha është e shkatërruar gjatë luftës së parë botërore, e cila gjerë më sot nuk është e rinovuar. Në këtë kishë në masë të madhe janë të dëmtuara kompozimet dhe freskat.

Në qytetin e Kumanovës gjinden kishat e Shën Nikolla dhe Shën Troica.

Kisha „Shën Nikolla” e njohur gjithashtu edhe si kisha e vjetër për shkakë se kisha e tashme është e njohur në themelet e kishës së vjetër. Kisha është e ndërtuar prej Andreja Damjanov, prej fshatit Popradishte prej rrethit të velesit. Ajo është e ndërtuar në gjysmën e dytë të shekullit 19 (1851/52). Kisha është e pasur me freska, galeri, mobilje kishtore interesante, ka oborr të mrekullueshëm me mure mbrojtëse të larta. Në oborr janë të vendosura edhe varrezat e eproreve kishtar.....

3.2 Xhamit dhe objektet tjera myslimane

Në regjionin turistik të Kumanovës dhe Likovës ekzistojnë shumë xhami, xhamia më e vjetër e cila është shumë e dëmtuar është në Tabanovc, për të cilën mendohet se është ngritur me gjysmën e dytë të shekullit XV menjëherë pas vendosjes së perandorisë Turke në këto hapësira. Paraprakisht duhet cekur se popullata në këto vise ka qenë e përcaktuar me religjion ortodoks dhe katolik. Megjithatë, thuhet se edhe para ardhjes së Turqve në këto vise ,islame ka qenë i pranuar prej numrit të vogël të njerëzve për shkak të inkuizicionit(përndjekje e njerëzve nga kisha)prej kishës katolike. Islami si religjion(fe) i ri ka qenë i përhapur kryesisht prej tregtarëve të ndryshëm të Lindjes së afërt të cilët kanë pasur kontakte me tregtarët e këtushëm. Megjithatë, gjatë shekullit XVII nën presion, edhe me gjasë për shkak të transparencës së madhe, dhe interesit të njerëzve për mundësitë e reja shoqërore dhe politike e kanë pranuar religjionin islam si fe

liberale dhe më moderne në krahasim me rolin e kishës në atë kohë, me rregullat e strikta shoqërore dhe organizative të kishës, posaçërisht nga ana e kishës katolike, e cila në njëfarë mënyre e ndalonte mendimin e lire të njerëzve për ndodhitë dhe proceset në gjeo dhe kozmohapsirën.

Sot në këto vise si mysliman paraqiten Shqiptarët, Romët, Boshnjakët, kuptohet Turqit, kurse ka edhe një numër i vogël Maqedon-Musliman prej viseve tjera të Maqedonisë të cilët kanë migruar në këto hapësira për shkak të interesit ekonomik (murator, tregtar, firmatorik).

Kur në qytetin e Kumanovës ka pasur vetëm një kish, qyteti ka pasur dy xhami prej të cilave njëra ka qenë e shkatërruar gjatë luftës së parë botërore, kurse vetëm njëra ekziston sot. Ajo është e njohur si Aksi Xhamia (Xhamia e vjetër). Në lagjet fshatare me popullatë myslimane (shqiptaret), ka Xhami të cilët disa prej tyre janë të vjetra, kurse ekzistojnë edhe disa të reja moderne me arkitekturë interesante: stili i ndërtimit të minareve, si dhe vet xhamia me stolisje të ndryshme arkitektonike, pjesë me pajisje moderne të cilat shërbejnë për lutje, dhe aktivitete tjera të hamameve mysliman.

Xhami më moderne me pamje të re arkitektonike janë në Matec (e cila është shkatërruar gjatë 2001), e cila ende nuk është rinovuar, pastaj xhamia në Nikushtak, Hotel (tre xhami) etj.

4. Specificiteti etnologjik

4.1 Motivet etnosociale folklor, tradita dhe muzika

Popullata e regjionit të Likovës me strukturën e saj nacionale është e ndryshme, e cila gjatë shekujve ka zhvilluar kulture të saj shpirtërore (hyjnore) dhe materiale. Duke u nisur nga fakti se kjo hapësirë gjendet në zemrën e Evropës Juglindore, me çka gjatë zhvillimit historik janë bërë ndryshime etnokulturore. Ndeshja e ndikimeve Perëndimore dhe Lindore mundëson që të krijohen forma specifike

etnosociale, në këtë hapësirë bashkarish jetojnë Shqiptar, Maqedoni, Serb,Rome etj.

Në këtë hapësirë hasen më shumë elemente etnologjike dhe folklorike, kënge, loje, tradita dhe prodhime të ndryshme shtëpiake, të cilët paraqesin grupe atraktive të motiveve të pavarur dhe komplementar të cilët ndikojnë në përmirësimin e strukturës të ofertës turistike dhe konsumit. Gjithashtu duhet cekur se ekzistimi i më shumë bashkësive nacionale, ka ndikuar në zhvillimin e veshjeve të ndryshme popullore në të cilën kanë dominuar ngjyra të ndryshme.

Melosi popullor dhe lojërat e popullatës prej bashkësive të ndryshme etnike karakterizohen me muzikë ritmike dinamike,e cila paraqet pasuri etnokulturore në muzikën folklorike. Manifestime të tilla janë të shpeshta,të cilat kanë efekt më të madh për valorizimin turistik.

Përfundimi

Regjioni i Likovës disponon me motive të shumta turistike të cilët mund të valorizohen dhe të paraqesin aktivitete turistike të rëndësishëm. Me bazë të asaj që është paraqitur në këtë punim mund të konstatohet se përmes pjesës receptive të ofertës turistike dhe shenjat kuantitative të hapësirës ekzistojnë mundësit reale për intenzivimin dhe diferencimin e lokaliteteve turistike në këto vise. Motivet natyrore-geografike dhe antropogjenë si ofertë turistike të cilat i ka në këto pjesë mund të lëviz proceset transformuese të lokaliteteve turistike (Kumanovë dhe banja e Kumanovës), Karadak (pejsazhi natyrore-turistik malor, turizëm liqenor, turizëm gjaku etj.

Komuna e Likovës me dy liqene akumuluese (Likovë dhe Glozhdë), me pejsazhë malore, kullosa të mrekullueshme, ultësira lumore karakteristike, ka mundësi reale për zhvillimin e turizmit. Gjithashtu duhet të ceket se në lagjet fshatare, posaçërisht në afërsi të qytetit të Kumanovës dhe në rrethinën e Likovës ka të ndërtuar shtëpi banimi individuale,të cilat dallohen prej arkitekturës së

zakonshme në vendin tonë. Ato kanë infrastrukturë banimi të zhvilluar moderne të cilët mundë të pranojnë numër të madh turistësh, me atë do të intensifikohej zhvillimi i turizmit fshatar.

Manastiri i Matecit, e liqeni i Likovës dhe Glazhda, lokacionet në fshatrat malore Strimë, Belanoc, Izvor, Rumice, janë të përshtatshëm për zhvillimin të turizmit rekreativ (pushim dhe rekreacion),për shkak se disponojnë me natyrë të bukur: vegjetacion të kullosave, pyllëzim, ujë burimor i ftohët, shtazë të egra etj.

Banja e Kumanovës me ujë termomineral kualitativ edhe më shumë mundë të rritet në qendër turistike. Për këtë duhen varg aktivitete të cilët kanë për qëllim afirmim dhe propagandë të vlerave turistike në këtë lokalitet turistik,ndërtim të kapaciteteve për vend pushim të kategorisë më të lartë, restorante, terrene sportive, parqe, gjelbërim. Gjithashtu është e nevojshme në vendet turistike,që zhvillohen.

Literatura

1. Зиков,М et al.(2001) Туристички региони во Република Македонија, Годишен зборник,ки 35-36, Универзитет Св. Кирил и Методиј,Институт за географија, Скопје.
2. Selmani,A.(1995):Likova dje,sot dhe nesër,Ekoritmi,shkup
3. Selmani,A.(2005):Rajoni i Likovës,Studim fiziko-gjeografik,Logos-5,Sak-stil,Shkup
4. Селмани.А(1992) Деградација,Просвета,Куманово.
5. Selmani, A.&Panov.N.(2004) Komunat e Republikës së Maqedonisë,Skaј,Skopje

6. Санев, В(1992) Неолит во Македонија, Водич низ археолошка поставка, Музеј на Македонија, Скопје.
7. Санев, В(1994) Младо камено доба, Археолошка карта на Република Македонија, том. 6, Скопје.
8. Филиповски Ѓ(1997) Почвите на Република Македонија-том Ш. Ману, Скопје.
9. Масевски, Д&Арсовски, М-Болто(1996) Куманово, прилози за изучување на неговото минато од праисторијата до денес, Куманово.
10. ^elevi, E (1967) Putopis, odlomci o Jugoslovenskim zemljama, Svjetlost, Sarajevo.
11. Здравковски, Д(1983-1984) Истражување на локалитетот На Брег село Младо Нагоричане, бр. 9, Macedonia Acta archaeologica, Скопје.
12. Cabej, E.(1977) Emri i Dardanisë dhe izoglosat shqiptaro-kelte në Studime gjuhësore, IV, Rilindja Prishtinë.
13. Novak, G(1969) La nazionalita dei Dardani in arhiv za Arbanasku starinu, jezik i etnologiju, knj. IV, sv. 1, Prishtine.
14. Здравковски, Д(1983-1984) Истражување на локалитетот На Брег село Младо Нагоричане, бр. 9, Macedonia Acta archaeologica, Скопје, 43-49.
15. Измајлов, Н(1960) Главне црте тектонике Македоније. Трудови на Геол. зав НРМ

PËRFITIMET NGA QASJA E PLANIFIKUAR PËR ZHVILLIMIN E DESTINACIONIT TURISTIK

Duke filluar nga efektet direkte, indirekte dhe efektet multiplikative të turizmit, dhe deri tek ato shoqëroro-politike, të gjitha janë të arritshme nëse e kuptojmë rëndësinë e qasjes të organizuar për destinacionin turistik. Turizmi është një element i rëndësishëm për ekuilibrin e jashtëm. Pikërisht ai mund të jetë një mjet për të ndryshuar vetëdijen negative. Produkti i planifikuar mirë e sinkronizon dhe drejton zhvillimin e destinacionit në drejtimin e dëshiruar. Qëllimi i tij është për të arritur përfitime ekonomike dhe sociale nga të cilat numri më i madh i qytetarëve, direkt ose indirekt, do të ketë përfitim ekonomik apo shoqëror. Prandaj qëllimi i krijimit të një produkti të njohur dhe me vet zhvillimin e turizmit mundësohet tërheqja e një numri më të madh vizitorësh, të realizohet një numër më i madh i qëndrimeve ditore dhe të realizohet konsum më i madh ditor.

Turizmi nëpërmjet kësaj:

- Do të bëhet një katalizator për lulëzim ekonomik..
- Në mënyrë të konsiderueshme do të rrisë kontributin e saj të drejtë për drejtë në ekonomi.
- Do të sillte rivitalizim në ekonominë e përgjithshme në kontekst të varësisë së saj nga hoteleria, transporti, ushqimoret, ndërtimet, energjetikës dhe sektorët e tjerë.
- Në mënyrë të rëndësishme do të ndikonte në zvogëlimin e normës së papunësisë.

- Do të hapte rrugë të tjera eksporti për kulturën, arsimin dhe sektorit për prodhim.
- Do të nxiste avancimin e infrastrukturës së qytetit (sportive, komunale, hotelerie, kulturore) dhe me atë do të rriste kualitetin e jetesës së gjithë qytetarëve.

Këto qëllime arrihen me rivënie e qasjes efektive e koordinuar dhe kooperuar për zhvillimin e turizmit në të cilin marrin pjesë grupe të sektorit publik dhe privat të cilët janë të lidhur, qoftë direkt ose indirekt me turizmin, si dhe me krijimin e promocionit efektiv të identitetit distinktiv të destinacionit turistik.

Karakteristik e përgjithshme e financimit të zhvillimit dhe funksionimit të ekonomisë turistike hotelerive tash më nëpër vite është financiarisht jo stabil: humbje në punë, jo likuiditeti, mungesa të burimeve investitor, pamundësi për pagesë të anuiteteve të arritura. Për atë shkak as amortizimi minimal nuk mund të përdoret si burim real. Shkaqet për këtë gjendje janë të shumta, afatgjate, globalisht të strukturuar, domethënë sistematike (sanksione, bombardimi nga ana e NATO-s), por është prezent edhe joballafaqimi dhe joorganizimi i ekonomisë turistike në gjurmë të likuidimit të këtij problemi dhe faktor ndalimi për zhvillim.

Për tu anashkaluar debalansi financiar në financimin e deritanishëm të reproduksionit, e patjetërsueshme është, para së gjithash, të mbulohen të gjitha humbjet (të kaluara dhe vijuese) dhe atë me mjete reale. Nëse kjo nuk realizohet, të gjitha vendimet të tjera nuk mund ti japin rezultatet e parashikuara. Mjete për mbulimin e humbjeve duhet së pari të sigurojë shteti:

- nëpërmjet vlerësimit më real të shërbimeve turistike,
- me lirimin nga një pjesë e tatimeve dhe kontributeve,
- me transferim e pagesave (kamatave) të të gjitha kredive për infrastrukturë,
- me sigurimin e burimeve buxhetore për mbulimin e humbjeve të mbetura.

Pasi që të stabilizohet financimi i reproduksionit të thjeshtë të ekonomisë turistike hotelerive, mund të projektohen zgjedhjeve për financimin e investimeve në destinacione të reja turistike. Sipas kësaj, edhe shteti edhe ekonomia turistike janë njëloj përgjegjëse dhe kompetente për vendosjen e vendimeve me të cilat mundën, në kohë reale, të formohen instrumente për vendosjen e balancit financiar dhe nxiqe zhvillimore në baza reale. Hapi i parë në atë drejtim është projektimi obligimeve faktike domethënë definimi i nivelit të akumulativitetit, niveli i vetfinancimit, niveli i obligimit, niveli i mundësive kreditore, përdorimi i amortizimit, mundësitë devizore për pagesë, që realisht i përcakton burimet personale për investim . Atyre duhet tu bashkëngjiten: burimet për komercializimin e pronës dhe burime për shitjen e kapitalit (aksione). Pritjet për investime të mëdha të huaja gati edhe janë të paralizueshme, kurse burimet investuese të brendshme dhe mekanizmat vendore sikur janë anashkaluar.

Edhe pas definimit të burimeve personale, niveli i tyre dhe kualiteti, mund të projektohen burime shtesë dhe burime të tjera të veçuara siç janë kreditë investuese, dhënie e koncesioneve, franshizing"productsharing", lizing,"timesharing" si dhe investime direkte të huaja. Nuk duhet të harrohet roli dhe përfitimi nga turoperatorët në zhvillimin e destinacioneve të reja turistike. Për kontributin e tyre as që nuk mund të bëhet fjalë për destinacione të reja receptive turistike, pasi që për një destinacion të panjohur (në kuptimin turistik) të bëhet destinacion i ri turistik, e patjetërsueshme është të sigurohen mjete të mëdha fillestare. Mirëpo, pasi që turoperatorët e mëdhenj më së shumti ndodhen nën pronësinë e bankave, kompanive të sigurimit ose korporatave të tjera të mëdha multinationale të cilat në baza të ndryshme e gjejnë interesin për investim kapital në tregje të reja turistike, atëherë në mënyrë indirekte në këtë financim marrin pjesë edhe tur operatorët. Në raste më të shpeshta roli kryesor dhe direkt i turoperatorëve në zhvillimin receptiv të destinacioneve të reja turistike shihet, para së gjithash, në agresivitetin e kampanjës promotive-shitëse të cilën turoperatorët e realizojnë në tregje emitive pas vendimit ta lidhin destinacionin e ri në programin e tyre. Në këtë kontekst, teza "për ti tërhequr turistet duhet të tërhiqen edhe turoperatorët" do të mund të ishte e

kapshme. Gjatë përpilimit të konstruksioneve të reja financiare duhet pasur parasysh ajo se investimet në kapacitetet e reja infrastrukturale kanë përpos efekteve stabilizuese edhe akcelervative efekte katalizatore ndaj aktiviteteve ekonomike në përgjithësi. Përveç asaj, koncepti i ri i financimit për ndërtim dhe eksplotim të infrastrukturës turistike patjetër duhet të jetë fleksibile dhe ti respektojë qasjet deri ne nivelet e saj, si dhe aspektet fazore. Në të më së shumti se deri tani duhet të jenë prezentë burimet private dhe logjika e tregut.

Në destinacionin e ri turistik, financimi dhe ndërtimi në infrastrukturën komunale më së shpeshti është detyrë e organeve lokale të qeverisë, që ta marrin koordinimin për ndërtim edhe atë në bashkëpunim me organet regjionale dhe qendrore të qeverisjes ose në bashkëpunim me agjencionet përkatëse.

Financimi i infrastrukturës mund të realizohet nga burimet buxhetore, nëpërmjet kredive (kapitali i tregut) dhe nëpërmjet koncesionit.

- Financimi nga burimet buxhetore nënkupton fluks të ngarkesave investuese ndaj tatim pagesve. Këto të dala mund të kombinohen me anë të pagesës së çmimit të shërbimit.
- Financimi nëpërmjet kapitalit të tregut (kredit), mjetet lidhen me çmimin e shërbimit. Huadhënësi i mjeteve mund të jetë ndërmarrje komunale ose drejtoria për zhvillim dhe menaxhim të destinacionit turistik. Kthimi i mjeteve kryhet nëpërmjet çmimit të shërbimeve komunale.
- Koncesionet si forma të financimit duhet të shfrytëzohen si mundësi për tejkalimin e problemeve komunale në fushat komunale, në destinacionin turistik veçanërisht për ndërtimin e rrugëve ekzistuese të cilat e lidhin destinacionin me rrugën magjistrale, financimi për ndërtimin e ujësjellësit dhe sistemin e kanalizimit. Koncesionet nuk duhet të shihen vetëm si formë stabile dhe bashkëkohore të financimit i cili ofron mundësi që të tërhiqet maksimumi nga konkurrenca, por edhe si parakusht për sjelljen e

vendimeve pozitive mbi investimet nga ana e investitorëve të vendit dhe të jashtëm.

Një nga detyrat e ardhshme më me prioritet të zhvillimit turistik të Republikës së Maqedonisë është ndërtimi i kapaciteteve akomoduese, gjatë së cilës nuk duhet të përsëriten gabimet e kohërave të mëparshme, kur intensivisht janë ndërtuar objekte akomoduese, gjatë asaj duke lënë mbas dore përmbajtje të ndryshme, të cilat gjithashtu janë të rëndësishme. Pikërisht përmbajtjeve të ndryshme (sportive, argëtuuese, tregtare, etj) duhet që të plotësohet mungesa të cilën oferta jonë turistike e ka në raport me konkurrentët tanë. Është e njohur se secili investim në objektet turistike është investim i madh, pa marr parasysh nga lloji i objektit. Koeficienti Kapital i cili në ndërtimet turistike është shumë i lartë, determinon kujdes gjatë investimeve në objektet turistike.

Patjetër duhet të konstatohet se edhe objektet e shtrenjta dhe të mëdha, pa klientët e duhur, në mënyrë të konsiderueshme të kontribuojnë për kushte të rënda pune të këtij regjioni. Tek ne, për fat të keq, në gjithë periudhën e kaluar kemi shumë shembuj për politiken investuese e udhëhequr në këtë mënyrë të gabueshme. Nga ana tjetër, ndryshueshmërinë e ofertës turistike e përbëjnë objekte te vogla ambientale të llojeve dhe tipave të ndryshme, dhe veçanërisht veprimtari të ndryshme. Kjo është shansi i sektorit privat, i cili është i vetmi që mund të shfaq laramani të ofertës turistike. Me një angazhim më të fuqishëm në sektorin privat hapet një fushë e gjerë e mundësive për punësimin e banorëve të profile të ndryshme, posaçërisht bashkëqytetarët tanë që kthehen nga vendet e jashtme ku gjenden me punë të përkohshme, me çka do të kontribuohet zgjidhja e problemeve dhe krijimi i mundësive për zhvillimin e turizmit në destinacione të reja.

Për tu mundësuar në mënyrë të papenguar të rrjedh zhvillimi i turizmit , e domosdoshme është që të sigurohet:

1. Në mënyrë të papenguar të funksionojë ekonomia e tregut me implementim të tërësishëm të ligjeve për tregun.
2. Klimë e përshtatshme politike dhe stabilitet në shtet,
3. Kurs real të valutës shtetërore dhe konvertibile,
4. Stabilitet të sistemit juridik i cili mbështetet në shtet juridik dhe mbisundimin e ligjit.
5. Mundësi për transfer të kapitalit të investuar dhe fitimi të realizuar.

Kontinuitet permanent dhe në të njëjtën kohë anashkalim i zhvillimit stihik të destinacionit turistik që nga fillimi mund të realizohet nëpërmjet formimit të drejtorisë për ndërtim dhe menaxhim me destinacionin turistik.

Drejtoria për zhvillim dhe menaxhim do të financohej nga burimet vijuese:

- Pjesëmarrjes së shtetit
- Pjesëmarrjes së investitorëve
- Nga të ardhurat të realizuara nga ndërtimi i objekteve për nevoja të tregut.

Drejtoria do të merret me këto aktivitete:

- Marketing-menaxhimin të destinacionit turistik
- Marketingun financiar dhe inxhinierik
- Inxhinjeri ndërtimore
- Krijimin e tokave për ndërtim
- Përpilimin e planeve urbanistike
- Kërkimet gjeodezike dhe gjeomekanike
- Investime në ndërtimin e objekteve në treg.

Turizmi paraqet nga njëra anë degë e ulët ekonomike akumulative, nga ana tjetër gjenerator i shumë degëve ekonomike.

Në shumë elemente të veprimit të saj në masë të madhe ndikon vullneti i shtetit, nëse ai i ndjek e jo ndihmon bartësit e zhvillimit në destinacionin turistik. Shteti ka mundësi që nëpërmjet masave monetare kreditore, politikës fiskale dhe investuese direkt të ndikojë në krijimin e rrethanave për financimin e investimeve të destinacioneve turistike. Domethënë në këtë kontekst shteti edhe njëherë duhet të afirmojë masa stimuluese të cilët në periudha të kaluara kanë dhënë efekte pozitive.

Është më se e qartë që turizëm mund të zhvilloj vetëm ai vend i cili disponon me resurse atraktive përkatëse, dhe e cila gjendet në një nivel të zhvillimit shoqëror, ngase zhvillimi turistik është i lidhur ngushtë me zhvillimin e aktiviteteve tjera ekonomike dhe jo ekonomike të cilët paraqesin kompleksitetin e ofertës turistike të ndonjë hapësire. Republika e Maqedonisë gjendet në fazën e tranzicionit që determinon kalim pronësie nga ai shoqëror në atë privat, por ende nuk ekziston hapësirë për bashkëpunim në bazë interesi të cilat do të jepnin rezultate pozitive qoftë në rrafshin logjistik apo të lidhjeve të marketingut.

Realizimi i të gjitha detyrave të parashtruara të cilat trajtohen si paragjykime për zhvillim të cilat do të mundësojnë ngritje të shpejtë të turizmit në destinacioneve të reja patjetër duhet të ndiqet nga organizimi adekuat i ekonomisë turistike, apo të aktivitetit turistik në përgjithësi.

Literatura

1. Bill Birnbaum: *Implementing Your Business Strategy*, 2006
2. Јаќоски, Б и Миладиноски, С. *Маркетинг и управување со маркетингот*, Ф.Т.У Охрид 1996
3. Jobber, D. *The Principles and Practice of Marketing*, London, McGraw-Hill, 1995
4. Kotler, P. *Principles of marketing*, Prentice Hall, 2004
5. Кожухаров, С. и Миладиноски, С. *Менаџерска Економија*, ФОН 2003
6. Миладиноски, С. *Маркетинг информативен систем во претпријатието* Ф.Т.У. Охрид 1994
7. Миладиноски, С. и Јаќоски Б. *Маркетинг во туризмот* Ф.Т.У. Охрид, 1989
8. Миладиноски, С. *Меѓународен Маркетинг*, Ф.Т.У. Охрид, 2004
9. Миладиноски, С. *Маркетинг информативен систем*, Прилеп 2004
10. Миладиноски, С и Кожухаров, С. *Менаџерска Економија*, ФОН 2004
11. Превала, Ш, и Ашталкоски, С. *Монетарна Економија*, ФОН 2004
12. Ракичевиќ, Г. *Менаџмент во туризмот*, Ф.Т.У. Охрид 2003.
13. Стаменковски, А. *Стратегиски Менаџмент* ЕУРМ 2006
14. Cooke, A. *The Economics of Leisure and Sport*, London, Routledge, 1994
14. Шуклев, Б. *Менаџмент*, УКИМ, Скопје, 2005

Msc. Vezir Halili

KAPITALIZMI VLERË DEMOKRATIKE APO DEHUMANIZËM

(KAPITALIZMI SISTEM I DOBISHËM APO RRËNUES MORAL)

Abstrakt

Fillimisht duhet të qartësohet se termi kapitalizëm do të thotë sovranitet i kapitalit, pra një sistem i lirë i pa kufizuar. Në mënyrë më të përgjithësuar mund të shpjegohet me aplikimin e teknologjisë së re, e mbështetur në fuqinë energjetike, në aplikimin e fuqisë elektromekanike apo mbështetur në mentalitetin e ri të biznesit amerikan.

Fjalët kyçe: Kapitalizëm, zhvillim, konkurrencë, demokraci, vlerë, moral.

Hyrje

Në këtë punim do të mundohemi të problematizojmë një çështje sa interesante aq edhe të vështirë "shoqërinë kapitaliste" e cila gjithnjë e më tepër po bëhet një arenë ku individët konkurrojnë me njëri-tjetrin në kushte shumë shtrënguese. Punimi paraqet një përsiatje krahasuese për pikëpamjet globale të ditëve të sotme.

Kur flitet për kapitalizmin në shumicën e rasteve, kuptohet si një sistem i tillë i organizimit shoqëror që kultivon si vlerë fundamentale "artin e fitimit të parasë" dhe se ky mentalitet kapitalist gjithnjë e më tepër po kultivohet në të gjitha shoqëritë në mbarë botën. Në këtë kontekst, duket se egoizmi i njerëzve po rritet

dhe ajo që meriton vëmendje nuk janë vlerat njerëzore, por zhvillimi ekonomik, dhe mallrat si vlerat më të rëndësishme të logjikës kapitaliste.

Me këtë formë të organizimit shoqëror, në lidhje me këtë sistem të shumë autorë, krijohet përshtypja është se po harrohet fakti se ata që eliminohen në këtë konkurrencë apo në këtë luftë të hidhur dhe atakohen nga kthetrat e varfërisë janë njerëz. Prandaj intenca është që në këtë rast të mundohemi të justifikojmë nëse sistemi i tillë i nxitjes së konkurrencës për para, dije, prestigj është vlerë apo sistem rrënues për moralin njerëzor.

Kapitalizmi dhe zhvillimi ekonomik

Bashkë me ndryshimet shumëdimensionale që ndodhën në politikë, ekonomi, jurisprudencë, ndërtimi i demokracive liberale, shumë autorë mendojnë se kishte influencë të theksuar edhe në kulturë, me që rast nënkuptohet "shfaqja e kulturës së re të konsumatorit masiv", e cila u shoqërua me ndryshimet në mënyrën se si amerikanët punonin, jetonin dhe kujdeseshin për njëri-tjetrin. Ajo gjithashtu solli ndryshime në moralin dhe identitetin personal³¹. Zhvillimi i këtillë përkatësisht, konsumerizmi i fuqizoi prirjet materiale të njerëzve në stilin e bazuar në konsumin e përbashkët.

Hovi i madh i zhvillimit ekonomik, veçmas në ShBA, Japoni dhe vendet e Evropës Perëndimore, krijoi kulturën e re ku dominon individualizmi, konkurrenca dhe fitimi.

Me evoluimet e më tejshme në këtë kontekst të zgjerimit të lirisë, këtë trajtë të organizimit shoqëro-politik, gjegjësisht triumfit të atij sistemi të organizimit shoqëror që FUKUYAMA e nominoi si "kapitalizmi dhe demokracia liberale" u nxitë një formë e jashtëzakonshme e konkurrencës së ideve që rezultoi me

³¹ Llambr Filo "Historia për shtetin e mirëqenies sociale" Fq.86.Tiranë.2000.Boton UT.

inovacione teknologjike në industri, bujqësi dhe veçmas në infrastrukturë. "Industria e shërbimeve, e cila po merrte hov në përputhje me rritjen e konsumit, po zhvillohej edhe në mbështetje të kalimit në mënyrë sa më komode, në përshtatje me mënyrën e re të jetesës urbane dhe me ndryshimin në artikulim që konsumoheshin. Frekuentimi i filmit, i klubeve sportive, sallave muzikore, institucioneve të artit, magazinave të reja të mëdha, restoranteve, moteleve dhe ambienteve të tjera çlodhëse jashtë qytetit në grupe e shoqëri kolektive-konsideroheshin shfaqje e një kulture të re"³²

Këto që përmendën më lartë janë argumente ilustrative, se rendi i ri botëror që në kontinuitet po zgjerohet nëpër botë, në trajtën e kapitalizmit dhe demokracisë liberale, është sistem i dobishëm për njerëzimin dhe nëse do të flisnim me gjuhën e utilitaristëve, rrjedhimisht edhe i moralshëm.

Optimist për këtë trajtë të organizimit shoqëror, dhe për përhapjen dhe fuqizimin e saj të mëtejshëm, madje si formë e pa konkurrencë në përmasa botërore janë shumë autorë, e veçmas Fukuyama meqë mendon se "kjo nuk është formë e ngurtë e determinizmit sikurse marksizmi, por një tendencë forcash themelore që e udhëheqin evolucionin shoqëror në mënyrë që të na tregojnë se duhet të ketë më shumë demokraci në fund të këtij procesi evolucionar se sa në fillim të tij"³³.

Shoqëria kapitaliste është shoqëri ku do të mund të gjejmë si komponent kryesor rritjen e standardit të jetesës, përmirësimin e kushteve materiale tej sigurimit të nevojave të jetesës (ushqim, veshje, strehim për shumicën e popullsisë). Në fakt në këtë perspektivë të ndryshimeve në strukturën sociale, të shoqëruara me ato në mënyrën e të menduarit, hidhen poshtë tezat e supozuara marksiste "të thellimit të antagonizmit klasor midis proletariatit dhe borgjezisë", "të intensifikimit të krizës së sistemit kapitalist". Shumë ndryshime ndodhën edhe në treguesit tjerë të civilizimit.

³² Po aty. Fq.85.

³³ Francis Fukuzama "Fundit i historisë dhe njeriu i fundit" Fq.417. Prishtinë. 2006. Zenith.

Njerëzit jetojnë më gjatë se më parë, kështu për shembull statistikat tregojnë se “mesatarja e jetëgjatësisë në Britani nga 46 vjeç për burrat dhe 51 për gratë në vitin 1900, në vitin 1975 ishte respektivisht 69 dhe 71 vjeç”.³⁴ Edhe më e ndjeshme ishte rënia e mortalitetit të foshnjave, gjithë kjo që po përmendim, fletë për ndryshimet kualitative që ka përjetuar shoqëria njerëzore kudo, e veçmas në perëndim, prandaj bazuar në këto të dhëna për kapitalizmin dhe demokracinë mund të flitet në mënyrë pozitive. Dilema fillestare në punën tonë në këtë rast, ishte nëse kapitalizmi ishte një sistem që i solli dobi njerëzimit apo jo, dhe shikuar nga ajo që problematizuar deri në këtë pikë,

përfundimet janë pozitive dhe shumë të kapshme.

Në sajë të kësaj konkurrence të ideve, politikave, mallrave që ofroi rendi i ri botëror në trajtën e kapitalizmit dhe demokracisë, sociologët si Giddensi mendojnë se “bota jonë është më e populluar dhe më e pasur se ndonjëherë tjetër, ne kemi mundësi të kontrollojmë fatin tonë dhe ta çojmë jetën tonë drejtë më të mirës, krejt e paimagjinueshme për brezat e më parshëm”.³⁵ Një përshkrim i tillë duket të jetë mjaft realist, dhe si i tillë është një mbështetje për atë konceptualizim fillestar, pra për kapitalizmin si sistem i organizimit shoqëror, që e konsideruam probabile që ai të jetë dobiprurës.

Kapitalizmi si dehumanizim

Në kapitullin paraprak përmendëm shumë elemente apo më mirë të themi analizuam kryesisht të mirat dhe dobitë e këtij sistemi për individin dhe shoqërinë. Në këtë kontekst u përmendën argumente të mjaftueshme për avantazhet e kësaj trajte të organizimit shoqërorë, ndërsa në këtë kapitull do të mundohemi të paraqesim të metat e këtij sistemi, respektivisht anët e dëmshme të tij për njerëzimin.

³⁴ Llambrò Filo “Historia për shtetin e mirëqenies sociale” Fq.154. Tiranë. 2000. UT

³⁵ Anthony Giddens “Sociologjia” Fq. 624. Tiranë. 2007. Sh.B. Çabej.

Andaj edhe përkundër efekteve pozitive që ka krijimi i shoqërisë së konsumit, ka edhe shfaqje negative. Këto shfaqje shpjegohen në mënyra të ndryshme nga autorë të ndryshëm që nënvizojnë një mori shpjegimesh, ndër të tjera përmendët konceptimi i botës “thjeshtë nga pikëpamja materialiste me mendimin se vetëm pasuria të jep kënaqësi dhe të qenurit i pasur të jep lumturi”³⁶

Të tjerë autorë mendojnë se ky moral kapitalist ka ndikim, e po fuqizohet në të gjitha shoqëritë e ditëve të sotme. Andaj mendohet se kjo është arsyeja që “në pjesën dërrmuese të vendeve, s’ka më bamirësi për të varfrit, të pushpresët dhe të gjymtuarit.

Edhe sikur të bien viktimë e sëmundjeve më të rënda e vdekjeprurëse, ata nuk janë në gjendje të gjejnë ndonjë ndihmë fizike apo njerëzore për tu mbrojtur. I varfri lihet në varfërinë e tij”³⁷.

Komente të tilla flasin në mbështetje të asaj dileme që ngritem që në artikullimin e titullit të këtij punimi, pra të konceptualizimit të kapitalizmit si dehumanizëm, që nënkupton rënien e interesit për cilësitë dhe vlerat morale, dhe rritjen e prirjeve si të thuash të një rendeje pas anës materiale.

Në këtë kontekst të paraqitjes dhe sistemimit, të përshkrimit të shfaqjeve negative në shoqëritë e sotme kapitaliste gjejmë edhe komente të tilla se ka “rritje të mërzisë, të ndjesisë së boshllëkut shpirtëror dhe shumë veprime, megjithëse përbënin qëllim në vetvete, për një pjesë njerëzve nuk ishin as të kënaqshme e as fitimprurëse. Disa nga shfaqjet më ekstreme të anëve negative ishin: etja për të grumbulluar para e sende materiale jo aq nga nevoja, se sa nga mania për tu dukur”³⁸

³⁶ Ll. Filo “Historia për shtetin e mirëqenies sociale”Fq.154. Tiranë.2000. UT

³⁷ Harun Jahja “Faqe qështit që sollë darvinizmi për njerëzimin” Fq.115. Shkup. 2003. ALB-BOOKS

³⁸ Ll. Filo. “Historia për shtetin e mirëqenies sociale”Fq. 155.Tiranë. 2000. UT.

Në këtë kulturë të konsumit, ekzistojnë edhe disa indikacione të tjera që flasin në një mënyrë ose në një tjetër për degradim të vlerave, me që rast do të nënkuptonim cenimin e familjes si njësi bazë e shoqërisë. Po rritet në kontinuitet numri i divorceve dhe po rritet besimi në ndershmëri e jetë familjare.

Shoqëria e konsumit ka edhe elemente të tjera negative si përhapja në shkallë të gjerë të pijeve alkoolike, drogave etj. Kjo çon në rritjen drastike të numrit të krimeve, në anën tjetër edhe përkundër rritjes së standardit të jetesës, jo të gjithë klasat, e grupacionet sociale përfitojnë në të njëjtën masë, nga mirëqenia e përgjithshme.

Në këtë kontekst të trajtimit të problemit dëshirojmë të nënvizojmë një shpjegim të dhënë nga njëri ndër kapitalistet më të mëdhenj George Soros kur thotë “ Një shoqëri transaksionesh i minon vlerat shoqërore dhe i shtur shtrëngesat morale. Vlerat shoqërore shprehin kujdesin për të tjerët. Ato nënkuptojnë se individi i përket një bashkësie, qoftë kjo familja, fisi, kombi ose njerëzimi, interesat e së cilës marrin përparësi mbi interesat vetjake të individit. Por një ekonomi tregu transaksionare mund të jetë çfarëdo, por jo një bashkësi. Secili duhet të shohë interesat e vet dhe skrupujt moralë mund të bëhen një barrë në një botë ku njeriu për njeriun është ujë”³⁹.

Nga kjo që cituam jepet me kuptua se Soros, fletë për shoqërinë kapitaliste në një mënyrë paksa të rezervuar, ku dominon individualizmi sepse njerëzit e shohin veten jo si pjesë të shoqërisë, por si “individ” që mbahen me këmbët e tyre, ku njeriu duhet të hyjë në konkurrencë, dhe vetë duhet të luftojë për zhvillimin dhe ruajtjen e avantazhit të vet. Probabiliteti i shkeljes së vlerave morale dhe i dehumanizimit të shoqërisë njerëzore, në këtë stad të konkurrencës dhe inovacioneve të panumërta

³⁹ George Soros “Kriza e kapitalizmit global” Fq. 75.Tiranë. 1999. Sh.B Toena

teknologjike është rritur në një mënyrë që nuk do të mund të imagjinohej para disa shekujve.

Prandaj e shohë si të justifikuar druajtjen e shprehur nga Fukuyama në kuptimin e krijimit të mundësisë "që biologjikisht të manipulojmë me veten tonë, qoftë përmes kontrollit të gjeneve qoftë përmes drogave të caktuara, ose përmes disa mënyrave të zgjatjes së jetës"⁴⁰

Natyrisht ky kërcënim është i mundshëm andaj konsideroj se pasojat e këtij dehumanizmi janë vështirë të parashikueshme. Në këtë rend të ri që po zgjerohet në kontinuitet u jepet një peshë, e pa mjaftueshme vlerave shoqërore të cilat po zëvendësohen me paranë. Prandaj, në këtë rast shihet se sa i sinqertë, po aq i guximshëm ishte qëndrimi i Sorosit kur thotë se "si pjesëmarrës anonim në tregjet financiare asnjëherë nuk më është dashur të peshoj pasojat shoqërore të veprimeve të mia"⁴¹. Të gjitha këto aspekte të përmendura deri më tani, janë të mjaftueshme për të bërë krahasime me ato të paraqitura në kapitullin e mëparshëm. Prandaj në punën e më tutjeshme, do të përpiqem t'i krahasoj të dy qasjet që kam paraqitur e që në masë të madhe janë inkompatibile.

Përfundime

Në punën e deri tashme kemi shpjeguar dy qasje të ndryshme apo më mirë të themi të papajtueshme sa i përket rendit të ri botëror, përkatësisht kapitalizmit dhe demokracisë liberale. Në kapitullin e parë kemi përmendur anët negative të këtij sistemi të organizimit shoqëror, dhe disa prej argumenteve të dhëna në këtë kapitull konsideroj se janë të pa kontestueshme, ndonëse koshient për ndërrimet e

⁴⁰ F. Fukuyama. "Fundi i historisë dhe njeriu i fundit" Fq.427.Prishtinë.2006. Sh.B. Zenith.

⁴¹ George. Soros. "Kriza e kapitalizmit Global" Fq. 196. Tiranë.1999. Sh.B. Toena.

perceptioneve nga shumë teoricien pas krizës së fundit që po përjetojnë vendet kapitaliste.

Pas rënies së sistemeve komuniste dhe ndryshimeve që kanë ndodhur, në kuptimin e ndërtimit të demokracive, ka ndodhur një rritje kualitative e standardit të jetesës, dhe rrjedhimisht edhe një rritje prej dhjetëra vitesh të mesatares së jetës së njerëzve. Njeriu u bë më i fuqishëm në tokë se kurrë më parë. Në këtë kontekst, ndryshime të këtilla ndaj bindjen, se janë rezultat i atij sistemi që ka nxitë konkurrencën e ideve, mallrave, projekteve, inovacioneve gjë që na shtynë të besojmë, se kapitalizmi është një trajtë e funksionimit të shoqërive që ka sjellë dobi të shumta.

Mirëpo, nuk duhet të jemi dogmatik në qëndrimin potencuar më lartë, për arsye se pranojmë edhe shumë prej justifikimeve që kam pas rastin t'i përmendi, por edhe disa të tjera që nuk kemi mundur t'i përmbledhim në këtë punim. Qasje këto që flasin për kapitalizmin si triumfues pas Luftës së Ftohët, por njëkohësisht si i paaftë për shërimin e sëmundjes së varfërisë botërore, padrejtësisë dhe eksploatimit.

Duke qenë të koshient për të metat, si dhe teprimet e shoqërisë së konsumit, përkujtojmë se nuk është e drejtë të thuhet se shoqëria kapitaliste nuk ka nevojë për korrigjime, por dilemën e ngritur në artikullimin e titullit, për kapitalizmin si dehumanizëm tanimë e kontestojë, pavarësisht prej faktit se shumë autorë e shohin si të tillë. Nuk mund të kuptohet kapitalizmi si dehumanizëm për një arsye të thjeshtë, se bota jonë është më e pasur, dhe jeta jonë është më e mirë, se e brezave para nesh (madje në nivelin global). Edhe pse pajtojmë me faktin se kapitalizmi nuk e shëroi sëmundjen e varfërisë, megjithatë jeta e të varfërve sot është më kualitative, se jeta e të pasurve të brezave para nesh.

Kultura e konsumerizmit vërtetë ka ndryshuar mënyrën e konceptimit të sistemit të vlerave, mirëpo megjithatë nuk është rrënuar i gjithë sistemi i jetës që ka qenë.

Natyrisht shumë autorë mendojnë se morali kapitalist ekzagjeron dhe e tej thekson si vlerë vetëm parandë. Por, megjithatë paraja ka qenë dhe është vlerë, në të gjitha

shoqëritë gjatë gjithë historisë së shoqërisë njerëzore. Prandaj kemi bindjen se kapitalizmi solli më shumë dobi për njerëzimin se sa dëme, natyrisht duke qenë koshient për të metat e tij.

BIBLIOGRAFIA

1. Dahredorf Ralf. Konflikti Shoqëror Modern.(Der moderne Sziale Konflikt) Tiranë, 1997. ShB. Dituria.
2. Filo Llabmro. Historia për Shtetin e Mirëqenies Sociale. Tiranë. 2000. Boton UT.
3. Fukuyama Francis. Fundi i Historisë dhe Njriu i Fundit. (The end of History and the Last Man). Prishtinë. 2006. Sh.B. Zenith.
4. Giddens Anthony. Sociologjia.(Sociology) Tiranë.2007. ShB. Çabej.
5. Jahja Harun. Fatkeqësitë që solli Darwinizmi për Njerëzimin. (The Disasters Drawinism Brought to Humanity) Shkup. 2003. ALB-BOOKS
6. Rubai Amër. Globalizmi dhe Bota Islame. Shkup. 2009. Sh.B. Furkan.
7. Soros George. Kriza e Kspitalizmit Global.(The Crisis of Global Capitalism) Tiranë. 1999. ShB. Toena

Literaturë shtesë

8. Revista "Argumenti" Nr. 33. Shkup. ShB. Mirësia
9. Barthlomew James. "Tema" Pse kapitalizmi është i mirë (Internet)
10. Lubonja Fatos Revista "Përpyjekja" (internet)

Fatmir Halili, MSc. kandidat

Arbitrazhi si formë alternative e zgjidhjes së kontesteve afariste

Abstrakt

Zhvillimet shoqërore-ekonomike dhe sociale njëkohësisht kanë ndikuar edhe në rritjen e kontesteve të ndryshme, e në veçanti atë të kontesteve afariste.

Rënia e efikasitetit të gjykatave për zgjidhjen e këtyre kontesteve për shkak të numrit të madh të lëndëve, ka bërë që të kërkohen forma alternative për zgjidhjen e tyre. Në këtë punim kemi elaboruar disa çështje esenciale të arbitrazheve tregtare, që paraqet njërën nga format alternative të zgjidhjes së kontesteve afariste në rrugë jashtëgjyqësore.

Fjalë kyçe: *Marrëveshje e arbitrazhit, Arbitër, Gjuha e arbitrazhit, Vendi i arbitrazhit, Vendim i arbitrazhit.*

Shqyrtime të përgjithshme për arbitrazhet

Në bazë të të dhënave mësohet se arbitrazhet kanë filluar të përdoren mjaft herët, që nga kohët më të lashta, sikurse përmend edhe Bennett: paraqitja e kontesteve për zgjidhje para një gjyqi privat ose vendimmarrësi, ka origjinë antike. Arbitrazhi është përmendur edhe në mitologjinë Greke dhe në Bibël⁴².

Arbitrazhet janë zhvilluar vazhdimisht dhe "si mënyrë specifike e vendosjes ka qenë e arsyeshme dhe e reklamuar pikërisht për atë që të jetë e aftë të

⁴²STEVEN C. BENNETT, ESQ-ARBITRATION-essential concepts, NLP IP Company, American Lawer Media, 2002, fq. 9

organizohet dhe të veproj në pajtim me nevojat e njerëzve afaristë⁴³. Palët zakonisht përcaktohen për arbitrazh për shkak të disa përparësive që posedojnë arbitrazhet në krahasim me gjykatat, p.sh. ato e bëjnë zgjidhjen më të shpejt të kontestit, arbitrit janë të zgjedhur nga vet palët dhe janë profesionist të lëmive të ndryshme të cilët garantojnë një ekzaminim më të mirë të çështjes, shpenzimet më të vogla, procedurat e arbitrazhit janë përgjithësisht private, rregulla fleksibile, etj.

Kjo metodë e zgjidhjes së kontesteve tregtare ka evoluar me kohën dhe sot "arbitrazhi ndërkombëtar është bërë metodë e themeluar të determinoj kontestet tregtare ndërkombëtare. Në tërë botën, shtetet kanë modernizuar ligjet e tyre duke marrë parasysh këtë fakt"⁴⁴. Dihet se janë shfaqur shumë më herët se në shekullin e XX edhe pse nuk dihet saktësisht se kur filluan të përdoren zyrtarisht konsiderohet se për të parën herë janë shfaqur në Angli⁴⁵.

Lëvizjet e njerëzve të cilët bënin tregti edhe jashtë vendeve të tyre, shkaktoj edhe lindjen e kontesteve të ndryshme tregtare, si dhe rrugë alternative për zgjidhjen më të mirë të tyre. Në këtë mënyrë "arbitrazhi ishte një metodë e themeluar për zgjidhjen e kontesteve midis tregtarëve dhe në industrinë detare në para-kolonitë Angleze. Në kolonitë amerikane para revolucionit, arbitrazhi luante një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e kontesteve"⁴⁶.

Zhvillimet ekonomike, e në veçanti lëvizjet e mëdha tregtare jashtë kufijve të shteteve kanë bërë që "në ekonominë e ditëve të sotit, shumë jurist, dhe shumë biznesmen shpejt ose vonë do të ndeshin arbitrazhin. Një ose një palë tjetër mund të sugjeroj që në vend të zgjidhjes gjyqësore, arbitrazhi të zgjidhet si metodë për

⁴³Mehdi Hetemi, E Drejta Ndërkombëtare Tregtare-afariste, Prishtinë, 2007, fq. 417

⁴⁴Alan Redfern and Martin Hunter, Law and Practice of International Commercial Arbitration, Sweet & Maxwell London NU3 3PF, 2004, fq. 1

⁴⁵Mihailo Jezdiq, E Drejta Ndërkombëtare Private II, Prishtinë, 1979, fq.136

⁴⁶STEVEN C. BENNETT,ESQ-ARBITRATION-essential concepts, NLP IP Company, American Lawer Media, 2002, fq. 9

zgjdhjen e kontesteve nën një marrëveshje⁴⁷. Përkritazi me këtë edhe studimi i kësaj lëmi paraqet një rëndësi të veçantë, në ditët e sodit.

Zhvillimin më të madh arbitrazhet e kanë në vendet perëndimore, ku zhvillimi ekonomik i këtyre vendeve gjendet në një nivel mjaft të lart siç janë: SHBA-të, vendet e Bashkimit Evropian, Japoni etj. Por përdorimi i tyre është duke shkuar vazhdimisht drejtë rritjes edhe në vende të tjera të botës paralel me zhvillimin e ekonomisë dhe tregtisë.

Pranë odave ekonomike të shumë shteteve janë themeluar tribunale të arbitrazhit (arbitrazhet institucionale) për të mundësuar zgjidhje më efektive të kontesteve ekonomike dhe njëkohësisht një besim më të madh për bizneset. Në këtë rast do të përmendja që Oda Ekonomike e Kosovës më 7 korrik të vitit 2010 ka nënshkruar një memorandum me USAID-in amerikan për themelimin e tribunalit të arbitrazhit.

Marrëveshja për arbitrazh

Marrëveshja e arbitrazhit është esenca e arbitrazhit, është baza me të cilën është themeluar dhe janë parapa veprimet kryesore procedurale si dhe çështja apo çështjet të cilat kanë lindur apo do të lindin, e të cilat do të zgjidhen përmes arbitrazhit. Një parim fundamental i të drejtës së arbitrazhit është që një arbitrazh duhet të rrjedh (procedoj) në bazë të marrëveshjes së arbitrazhit të lidhur midis palëve⁴⁸.

Kur përmendim çështjet të cilat kanë lindur apo do të lindin, në këtë kontekst njohim dy lloje të marrëveshjeve të arbitrazhit: "Klauzola e kompromisit (klauzola e arbitrazhit) dhe Kompromisi. Klauzola e kompromisit parasheh

⁴⁷Po aty, fq.3

⁴⁸ Moser Michael J, and Cheng Teresa Y.W, Hong Kong Arbitration, A User's Guide, KLUWER LAW INTERNATIONAL, 2004, fq.31

zgjdhjen e kontesteve të ardhshme me anë të arbitrazhit. Klauzola është e kyçur në përmbajtjen e kontratës bazë ose asaj i shtohet. Kompromisi i arbitrazhit nënkupton zgjidhjen e kontestit veç të krijuar me anë të arbitrazhit⁴⁹.

Hartimi i marrëveshjes së arbitrazhit nuk është punë e lehtë, sepse në një marrëveshje të arbitrazhit inkorporohen çështjet më të rëndësishme të cilat mund të kenë influencë në rezultatin përfundimtarë të procesit të arbitrazhit. Në të parashihen çështjet si: zgjedhja e arbitrave, vendi i arbitrazhit, gjuha e arbitrazhit, e drejta që do të zbatohet arbitrazhi, niveli i konfidencialitetit etj. Për këtë arsye është mirë që në hartimin e marrëveshjes për arbitrazh të marrin pjesë ekspert që janë njohës të mirë të çështjeve të arbitrazheve, si dhe ekspert të tjerë nga fusha përkatëse në të cilën ka lindur kontesti.

Një rol qendror dhe element esencial në marrëveshjen e arbitrazhit paraqet elementi i pëlqimit apo vullnetit të palëve për zgjidhjen e kontestit apo kontesteve të tyre përmes arbitrazhit, sepse ky paraqet elementin esencial pa të cilin element edhe arbitrazhi nuk mund të jetë valid⁵⁰. Kjo paraqet pikën determinuese, si të arbitrazhet tregtare ndërkombëtare ashtu edhe të arbitrazhet e tregtisë së brendshme dhe arbitrazhet në të drejtën ndërkombëtare publike.

Dy elemente të rëndësishme rrjedhin nga ekzistimi i një marrëveshje valide të arbitrazhit: 1. Kontestet të cilat janë brenda fushës së marrëveshjes së arbitrazhit nuk mund të ketë qenë më parë në gjykatë dhe 2. Organizimi i tribunalit të arbitrazhit, juridiksioni i tij dhe procedurat e tij të gjitha duhet krijuar sipas dispozitave të përmbajtura në marrëveshjen e arbitrazhit⁵¹.

⁴⁹ Mehdi Hetemi, E Drejta Ndërkombëtare Tregtare-afariste, Prishtinë, 2007, fq. 419

⁵⁰ Alan Redfern and Martin Hunter, Law and Practice of International Commercial Arbitration, Sweet & Maxwell London NU3 3PF, 2004 fq. 7

⁵¹ Moser Michael J, and Cheng Teresa Y.W, Hong Kong Arbitration, A User's Guide, KLUWER LAW INTERNATIONAL, 2004, fq. 31,32

Nëse nuk ekziston marrëveshja e palëve ku është shprehur vullneti dhe pëlqimi i tyre që kontesti apo kontestet e tyre të zgjidhen përmes arbitrazhit atëherë zgjidhja e tyre kërkohet përmes gjykatave të rregullta.

Në çdo konventë ndërkombëtare dhe ligj nacional marrëveshja e arbitrazhit përcaktohet si marrëveshje midis palëve në të cilën shprehet vullneti i tyre i lirë që kontesti ose kontestet e tyre të zgjidhen përmes arbitrazhit. Marrëveshja e arbitrazhit është një marrëveshje midis palëve e paraqitur para arbitrazhit për një ose të gjitha kontestet të cilat janë shfaqur ose të cilat mund të shfaqen midis tyre në marrëdhënie të përcaktuara ligjor. Një marrëveshje e arbitrazhit mund të gjendet në formë të një klauzole të arbitrazhit, në një kontratë ose në formë të një marrëveshje të veçantë⁵².

Ligji për arbitrazhet i Kosovës marrëveshjen e arbitrazhit e përcakton si "marrëveshje e arritur ndërmjet dy ose më shumë personave, që disa ose të gjitha kontestet juridike, të cilat kanë lindur ose që mund të lindin ndërmjet tyre, do t'i nënshtrohen arbitrazhit"⁵³. Të gjitha mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me kërkesa civile-juridike dhe ekonomiko-juridike mund t'i nënshtrohen arbitrazhit, përveç nëse është e ndaluar me ligj⁵⁴.

Forma e marrëveshjes në të gjitha konventat ndërkombëtare si dhe ligjet nacionale është paraparë që të jetë me shkrim. Ligji model i UNCITRAL-it e parashikon në këtë mënyrë: "Marrëveshja e arbitrazhit bëhet me shkrim. Një marrëveshje është me shkrim në qoftëse ajo përmbahet në një dokument të firmosur nga palët ose në një këmbim letrash, telefaks, telegrame ose mënyra tjera të telekomunikimit të cilat sigurojnë një regjistrim të marrëveshjes"⁵⁵.

Ka edhe përjashtime kur ligjet nacionale lejojnë që marrëveshjet e arbitrazhit të bëhen me gojë, por janë raste të rralla. Marrëveshjet e arbitrazhit mund

⁵² Shih ligjin Model të UNCITRAL-it, neni 7.1

⁵³ Ligji për arbitrazhet i Kosovës, neni 2.1

⁵⁴ I njëjti ligj, neni 5.1,2

⁵⁵ Ligji model i UNCITRAL-it, neni 7.2

të marrin forma të ndryshme. Ato mund të jenë shumë faqëshe (vëllimore), ose mund të jenë shumë të shkurtra⁵⁶. Në marrëveshjet shumë faqëshe zakonisht parashihen të gjitha çështjet në mënyrë më të hollësishme dhe tribunalit të arbitrazhit i mbeten shumë pak çështje për të përcaktuar. Ndërsa në marrëveshjet e shkurtra, me vëllim të vogël, parashihen kryesisht çështjet më esenciale ndërsa shumë çështje të tjera i lehen në kompetencë tribunalit të arbitrazhit që t'i përcaktoj.

Si rrjedhim i autonomisë së palëve ndodh që palët në kontratën kryesore të parashohin ligje të ndryshme për drejtimin e procedurës. Për një pjesë të procedurës të jetë ligj i aplikueshëm një ligj tjetër kurse për pjesën tjetër një ligj tjetër⁵⁷. Kjo nuk do të ishte e preferueshme sepse do të bënte procedurën më komplekse dhe do të shkaktonte më shumë vonesa. Andaj aplikimi i një ligji të vetëm për tërë procedurën do të ishte më praktik dhe i arsyeshëm.

Emërimi i arbitrave

“Në disa gjuhë fjala “arbitër” është e njëjtë me fjalën e përdorur “gjyqtar” ose “arbitër” në ngjarjet sportive. Për shembull në gjermanisht fjala “Schiedsrichter”, dhe në greqisht “διαιτητής”, do të thotë si njëra edhe tjetra gjyqtar ose arbitër”⁵⁸. Në gjuhën tonë përdorën edhe njëri edhe tjetri. Me fjalën gjyqtar zakonisht u referohemi gjyqtarëve të rregullt të gjykatave shtetërore, ndërsa me fjalën arbitër u referohemi personave të zgjedhur në një arbitrazh. Kurse në sport përdoren edhe njëri edhe tjetri dhe kanë kuptimin e njëjtë.

Palët janë të lira që në marrëveshjen e tyre për arbitrazh të vendosin edhe për zgjedhjen e arbitrave dhe numrin e tyre, të cilët do të gjykojnë në lidhje me kontestin. Nominimi i arbitrave është një çështje mjaft e rëndësishme. Një selektim

⁵⁶ Julian D. M. Lew, Loukas A. Mistelis, Stefan M. Kroll, *Comparative International Commercial Arbitration*, Kluwer Law International, 2003, fq. 100

⁵⁷ Po aty. Fq. 107

⁵⁸ Po aty. Fq. 521

i mirë i arbitrave do të thotë shumë për procedurën e arbitrazhit dhe përfundimin e kontestit në një mënyrë të drejtë. "Një arbitër i shkathët dhe me përvojë është një prej elementëve kyç për një arbitrazh të paanshëm dhe efektiv"⁵⁹.

Këto arbitrazhe "janë formuar pranë odave ekonomike (tregtare) si asociacione të odave dhe si asociacione të ekonomisë. Më e njohura është gjyqi ndërkombëtar i arbitrazhit pranë Odës Tregtar Ndërkombëtare me seli në Paris"⁶⁰.

Zakonisht emërohet një arbitër ose tre arbitra por numri i arbitrave mund të jetë edhe më i madh nëse palët janë marrë vesh për një gjë të tillë, por numri i arbitrave në çdo rast duhet të jetë tekë.

Nëse palët nuk janë marrë vesh në lidhje me caktimin e arbitrave atëherë caktimi i tyre bëhet nga tribunali i arbitrazhit, në bazë të së drejtës kompetente të zgjedhur nga palët. Në ligje zakonisht parashihet që secila palë e emëron nga një arbitër, pastaj arbitrit e emëruar e zgjedhin arbitrin e tretë, Ligji Model përcakton që "në një arbitrazh me tre arbitra, secila palë do të caktoj një arbitër, dhe të dy arbitrat e caktuar do të caktojnë arbitrin e tretë; nëse njëra palë nuk e emëron arbitrin brenda tridhjetë ditëve nga pranimi i kërkesës për ta bërë këtë, ose nëse dy arbitërat nuk merren vesh për emërimin e arbitrit të tretë brenda tridhjetë ditëve nga emërimi i tyre, atëherë me kërkesën e njëres palë caktimi i arbitrit bëhet prej gjykatës ose ndonjë autoriteti tjetër"⁶¹.

Për nominimin e një arbitri merren parasysh një varg karakteristikash si p.sh: arbitri duhet të jetë i pavarur, i paanshëm dhe të mos ketë ndonjë konflikt interes⁶².

⁵⁹ Alan Redfern and Martin Hunter, . Law and Practice of International Commercial Arbitration, Sweet & Maxwell London NU3 3PF, 2004 fq.9

⁶⁰Mehdi Hetemi, E Drejta Ndërkombëtare Tregtare-afariste, Prishtinë, 2007, fq.425

⁶¹ Ligji Model, neni 11, par 1

⁶² Ligji i Kosovës për arbitrazhet, neni 9.6

Për arbitra zakonisht zgjedhën personat që janë ekspertë të lëmive të caktuara. Kjo sa është e mirë po aq mund të jetë edhe e dëmshme, sepse personat e caktuar shpeshherë nuk janë juristë dhe nuk i njohin procedurat ligjore gjë që mund të ndikoj edhe në rezultatën përfundimtarë.

Është mirë që arbitrit të jenë jurist me përvojë të cilët i njohin mirë ligjet dhe bëjnë interpretimin e drejtë të tyre, sepse për ndihmë tjetër në procedurë, nga tribunali i arbitrazhit thirren edhe ekspert të lëmive të caktuara.

Në një tribunal që ka më shumë arbitra në përbërje të tij do të ishte mirë që arbitrit të jenë me profesione të ndryshme duke përfshirë edhe juristë, kjo do të ishte përbërja më ideale për një gjykim më të drejtë të çështjes, sepse do të kishim një kombinim midis ekspertëve që i njohin procedurat dhe atyre që e njohin problemin me të cilin ka të bëjë kontesti.

Mund të ndodh që gjatë procedurës të paraqitet nevoja që të bëhet zëvendësimi i një arbitri ose përjashtimi i një arbitri për arsye të ndryshme, por "nuk ka dispozita në lidhje me përgjegjësin e arbitrave ndaj palëve"⁶³.

Gjuha e arbitrazhit

Kur palët janë nga vende të cilat e përdorin gjuhën e njëjtë nuk ekziston ndonjë problem sepse ato e përdorin gjuhën e tyre p.sh. kur njëra palë është nga SHBA-të e tjetra nga Mbretëria e Bashkuar ato do të përdornin gjuhën angleze, por problemi i gjuhës paraqitet në rastet kur palët janë nga vende të cilat kanë gjuhë të ndryshme p.sh. njëra nga Gjermania e tjetra nga Kroacia, atëherë paraqitet problemi i përcaktimit të gjuhës e cila do të përdoret në procedurë.

⁶³ Programi sistemi i përmbarimit të marrveshjeve dhe vendimeve në Kosovë (SEAD), Raport dhe rekomandime për zhvillimin dhe zbatimin e suksesshëm dhe efektiv të sistemit për zgjidhjen alternative të mosmarrveshjeve, 30 prill 2010, fq. 9

Gjuha e arbitrazhit e përcakton edhe gjuhën e vendimit. Kur dokumenti i dëshmuar është në një gjuhë tjetër, dëshmia duhet të përkthehet në gjuhën e arbitrazhit ose alternative, arbitrazhi mund të drejtohet me fleksibilitet kështu që dëshmia mund të jetë marrë në një gjuhë tjetër⁶⁴.

Kur palët janë nga vende të ndryshme dhe flasin gjuhë të ndryshme ato zakonisht gjuhën që do të përdoret në procedurën e arbitrazhit e caktojnë në marrëveshjen e tyre për arbitrazh. Por ekzistojnë edhe raste kur palët nuk janë akorduar për një gjë të tillë. Atëherë caktimin e gjuhës e bënë tribunali i arbitrazhit në bazë të së drejtës kompetente.

Ligjet orientojnë që tribunali të marrë parasysh rrethanat përkatëse, e si zakonisht gjuhën në të cilën është shkruar kontrata. Në mungesë të një marrëveshje mes palëve, tribunali i arbitrazhit do të përcaktojë gjuhën ose gjuhët e arbitrazhit, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, posaçërisht gjuhën në të cilën është shkruar kontrata⁶⁵.

Ose në ligjin e Kosovës për arbitrazhet thuhet: “përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, tribunali i arbitrazhit e përcakton gjuhën e procedurës së arbitrazhit, e cila do të përdoret për të gjitha deklaratat dhe parashtresat me shkrim dhe me gojë. Tribunali mund të urdhërojë përkthimin e dokumenteve përkatëse në gjuhën për të cilën palët janë akorduar” (neni 19). Mënyra e përcaktimit të gjuhës është bërë në mënyrë të njëjtë edhe në Ligjin Model të UNCITRAL-it dhe në dokumente të tjera ndërkombëtare si dhe në ligjet shtetërore.

Kur palët janë nga vende të ndryshme dhe flasin gjuhë të ndryshme do të ishte mirë sikur ato të dakordoheshin për njërën nga gjuhët e tyre. Nëse ato do të akordohen për një gjuhë tjetër do tu shkaktoheshin vonesa më të mëdha në

⁶⁴ Moser Michael J, and Cheng Teresa Y.W, Hong Kong Arbitration, A User's Guide, KLUWER LAW INTERNATIONAL, 2004, fq. 46

⁶⁵ Rregullat e arbitrazhit të Odës Ekonomike Ndërkombëtare, neni 15

përkthime e po ashtu edhe shpenzime shtesë, sepse do të kishim përkthim në dy gjuhë nga gjuha e përcaktuar nga palët.

Vendi i arbitrazhit

Vendi i arbitrazhit konsiderohet vendi ku arbitrazhi do të ushtroi veprimtarinë e vetë deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, ku vendimi i arbitrazhit do të nxirret formalisht, p.sh. në Shqipëri vendi i arbitrazhit do të konsiderohet Shqipëria.

Vendi i arbitrazhit (shpesh referuar si “qendra” e arbitrazhit) është tipik pajtim i palëve në marrëveshjen e arbitrazhit⁶⁶. Në mënyrë të njëjtë sikurse për gjuhën e arbitrazhit ashtu edhe për vendin e arbitrazhit në mungesë të marrëveshjes në mes palëve, konventat ndërkombëtare si dhe ligjet e shteteve në të cilat rregullohet çështja e arbitrazheve, i japin të drejtën tribunalit të arbitrazhit të caktoj vendin e mbajtjes së procedurës së arbitrazhit duke marrë parasysh rrethanat e arbitrazhit⁶⁷.

Si rrethana përkatëse merren: vendi më i afërt për palët, vendi më i përshtatshëm për mbajtjen e dëgjimeve, shikimin e sendeve ose dokumenteve etj. p.sh në ligjin e Kosovës thuhet që tribunalit të arbitrazhit mund të takohet në cilindo vend që e konsideron të përshtatshëm për mbajtjen e dëgjimit të palëve, të dëshmitarëve ose të ekspertëve, mbajtjen e konsultimeve ndërmjet anëtarëve të tribunalit të arbitrazhit dhe për shikimin e sendeve ose dokumenteve⁶⁸.

Përkundër lirisë së palëve që të zgjedhin të drejtën meritore, sipas të cilës do të vendoset kontesti, si dhe ti kontraktajnë shumë çështje të cilat kanë të bëjnë

⁶⁶ Moser Michael J, and Cheng Teresa Y.W, Hong Kong Arbitration, A User's Guide, KLUWER LAW INTERNATIONAL, 2004, fq. 44

⁶⁷ Rregullat e arbitrazhit të UNCITRAL-it, neni 16.1

⁶⁸ Ligji i Kosovës për arbitrazh, neni 17.2

me çështjet procedurale dhe sjelljes së vet arbitrazhit, kjo nuk do të thotë se është e lejuar që me marrëveshje të palëve të përjashtohet aplikimi i disa rregullave të së drejtës së vendit të arbitrazhit. “Vendi i arbitrazhit është me rëndësi në arbitrazhin tregtar ndërkombëtar, për arsye se vendin e arbitrazhës e përcakton lex arbitri. Lex arbitri është e drejta e cila është meritore në procedurën e arbitrazhit”⁶⁹. Rëndësia e vendit të arbitrazhit është e trefishtë. E para, përcakton se e drejta e arbitrazhit e cilit juridiksion do të rregulloj (qeveris) drejtimin e arbitrazhit. E dyta, vendi i arbitrazhit e fikson vendin e vendimit, me fjalë të tjera, ku Hong Kongu është përcaktuar si vend i arbitrazhit, vendimi do të konsiderohet të jetë nxjerr në Hong Kong. Së treti, vendi i arbitrazhit specifikon cila gjykatë mund të ushtroj përkrahjen dhe mbikëqyrjen e fuqisë mbi arbitrazhet dhe shkallën në të cilën gjykatat mund të intervenojnë⁷⁰.

Po ashtu vendi i arbitrazhit është i rëndësishëm sepse çështja “se a është kërkesa e caktuar arbitrabile, këtë e përcakton e drejta e shtetit e selisë së arbitrazhit, kurse palët kontraktuese janë të kufizuara nga rendi publik, ose të rregullave juridike – imperative”⁷¹. Kjo do të thotë që palët duhet të jenë të vëmendshme gjatë hartimit të marrëveshjes së arbitrazhit dhe të kenë parasysh ligjet pozitive të shtetit ku do të jetë selia e tribunalit të arbitrazhit.

Vendimet e arbitrazhit

Vendimet e arbitrazhit njëherit paraqesin edhe përfundimin e procedurës së arbitrazhit. Të gjitha veprimet që ndërmerr arbitrazhi kurorëzohen me marrjen e vendimit përfundimtarë, siç thekson edhe Turner: “vendimi i arbitrazhit duhet të jetë si rrjedhim i peshimit të pretendimeve të kundërta të palëve, dëshmive dhe

⁶⁹ Mehdi Hetemi, E Drejta Ndërkombëtare Tregtare-afariste, Prishtinë, 2007, fq.430

⁷⁰ Moser Michael J, and Cheng Teresa Y.W, Hong Kong Arbitration, A User's Guide, KLUWER LAW INTERNATIONAL, 2004, fq. 44,45

⁷¹ Mehdi Hetemi, E Drejta Ndërkombëtare Tregtare-afariste, Prishtinë, 2007, fq.430

parashtrësive të paraqitura gjatë procedurës⁷². Nga kjo nënkuptohet se vendimi paraqet vlerësimin e provave dhe fakteve të paraqitura gjatë procedurës.

Vendimi përfshin të gjitha urdhrat e nxjerra nga tribunali i arbitrazhit, qofshin ato të përkohshme, të pjesshme, procedurale, meritore ose përfundimtare, lidhur me të gjitha çështjet, përfshirë këtu edhe shpenzimet⁷³.

Në Hong Kong, përgjithësisht janë të njohura dy lloje të vendimeve:

1. Vendimi përfundimtarë (me të cilin vendoset për të gjitha çështjet e referuara në arbitrazh) dhe
2. Vendimi i përkohshëm apo i pjesshëm (me të cilin tribunali vendos për disa çështje, të tilla si juridiksioni, çështjet prejudiciale etj.)⁷⁴.

Vendimi nxirret konform të drejtës së përcaktuar nga palët sepse “palët e kanë ndikimin kryesor në përcaktimin e rregullave procedurale në lidhje me zgjedhjen e të drejtës materiale, por mund të përcaktojnë edhe atë që vendimi të nxirret pa u mbështetur në ndonjë të drejtë materiale⁷⁵. Ligji Model, Ligji i Kroacisë, Ligji i Kosovës etj. i mundësojnë tribunalit të vendos *ex aequo et bono* (“sipas se drejtës dhe se mirës” ose “nga barazia dhe ndërgjegja”) vetëm nëse palët shprehimisht e kanë autorizuar për këtë.

Shpenzimet e arbitrazhit

Gjatë gjithë procedurës së arbitrazhit shkaktohen dhe shpenzime të veçanta siç janë p.sh. shpenzimet për pagesën e arbitrave, pagesat e ekspertëve apo e ndonjë ndihme tjetër të cilën e kërkon tribunali i arbitrazhit, shpenzimet e udhëtimit etj.

⁷² Ray Turner, *Arbitration Awards- A Practical Approach*, Blackwell Publishing Ltd, 2005, fq. 3

⁷³ Ligji i Kosovës për arbitrazh, neni 2.2

⁷⁴ Moser Michael J, and Cheng Teresa Y.W, *Hong Kong Arbitration, A User's Guide*, KLUWER LAW INTERNATIONAL, 2004, fq. 74

⁷⁵ Mehdi Hetemi, *E Drejta Ndërkombëtare Tregtare-afariste*, Prishtinë, 2007. fq. 417

Në arbitrazhet tregtare ndërkombëtare shpenzimet janë edhe më të mëdha për shkak se shpeshherë largësia e palëve është mjaft e madhe dhe shpenzimet e udhëtimit janë të kushtueshme, palët vijnë nga vende të ndryshme që kanë gjuhë të ndryshme dhe paraqitet nevoja për përkthime qoftë gjatë shqyrtimeve gojore ose, të dokumentacionit, etj. Për këtë arsye gati të gjitha konventat ndërkombëtare dhe ligjet nacionale e parashohin këtë çështje dhe e rregullojnë në mënyrë të veçantë.

Megjithatë, procedurat e arbitrazhit janë më të shpejta se ato gjyqësore, gjë që bënë shmangien e shumë shpenzimeve dhe në këtë aspekt e sjell në avantazh arbitrazhin kundrejt gjykatave.

Që nga e drejta pandekte vlen rregulla se pala e cila humb gjykimin jo vetëm që i bart shpenzimet që i ka shkaktuar me veprimet e saja, veçse ka detyrë që t'ia paguaj të gjitha harxhimet palës gjyqë fituese⁷⁶. Edhe ligji i Kosovës për arbitrazhin ka qasjen "humbësi paguan" që kërkon nga pala humbëse të bart të gjitha shpenzimet përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, por tribunali i arbitrazhit mund të ndajë shpenzimet ndërmjet palëve, nëse konstaton se një ndarje e tillë është e arsyeshme duke marrë parasysh rrethanat e rastit⁷⁷.

Palët mund të merren vesh për shpenzimet edhe në marrëveshjen e tyre për arbitrazh dhe që nga fillimi të përcaktohen se si do të bëhet pagesa e shpenzimeve të procedurës. Po ashtu palët me marrëveshje shpeshherë caktojnë edhe një arkëtar⁷⁸ që do të merret ekskluzivisht me çështjen e shpenzimeve, kjo zakonisht përfshihet në planin e punës të tribunalit. Nëse kjo çështje nuk është parapa me marrëveshjen e palëve atëherë në lidhje me çështjen e shpenzimeve vendos tribunali i arbitrazhit, që zakonisht caktohet në vendimin përfundimtarë.

Ligji i Kosovës ka përfshi në shpenzime:

⁷⁶ Faik Brestovci, *E Drejta Procedurale Civile I*, Prishtinë, 2004, fq. 375

⁷⁷ Ligji i Kosovës për arbitrazh, neni 34.3

⁷⁸ Julian D. M. Lew, Loukas A. Mistelis, Stefan M. Kroll, *Comparative International Commercial Arbitration*, Kluwer Law International, 2003, fq. 528

1. "Taksën e tribunalit të arbitrazhit;
2. Shpenzimet e arbitrave;
3. Shpenzimet për ekspertë dhe ndihmë tjetër të cilën e ka kërkuar tribunalin i arbitrazhit dhe për të cilën janë pajtuar palët;
4. Shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e tjera të dëshmitarëve, deri në masën e miratuar nga tribunalin i arbitrazhit;
5. Shpenzimet për përfaqësimin dhe ndihmën për palën e suksesshme, nëse kompensimi i këtyre shpenzimeve është kërkuar gjatë procedurës së arbitrazhit dhe vetëm deri në atë masë që tribunalin i arbitrazhit e cakton të arsyeshme; dhe
6. Të gjitha taksat dhe shpenzimet e gjykatës kur kjo bënë emërimin e arbitrave"(neni34, par.1).

Llojet e shpenzimeve ndryshojnë varësisht nga rasti, në veçanti në arbitrazhet tregtare ndërkombëtare. Në përcaktimin e vlerës së taksave merren parasysh: vlera e kontestit, kompleksiteti i lëndës, koha e shpenzuar si dhe rrethana të tjera varësisht nga rasti⁷⁹.

Konkluzion

Arbitrazhi paraqet një rëndësi prej zgjidhjeve alternative të kontesteve tregtare. Zgjidhja alternative e kontesteve përfshinë një spektër të gjerë të zgjidhjeve të kontesteve jashtë gjykatave, si negociatat e drejtpërdrejta në mes të palëve, ndërmjetësimin dhe arbitrazhin. Sikurse edhe procesi gjyqësor, edhe arbitrazhi është proces për vendosjen e kontesteve, por sidoqoftë ai është proces privat i cili është më fleksibil dhe më efikas sesa shqyrtimet gjyqësore.

⁷⁹ Shih neni 39 i Ligjit Model të UNCITRAL-it, neni 34.2, i ligjit të Kosovës për arbitrazhet, neni 35 i ligjit të Kroacisë për arbitrazhet etj.

Në këtë mënyrë përmes arbitrazhit kontestet tregtare zgjidhen më shpejtë dhe në mënyrë më efektive duke krijuar një avantazh ndaj zgjidhjes gjyqësore të kontesteve. Kjo ka bërë që shumë konteste afariste të orientohen për zgjidhje përmes arbitrazhit. Si formë e zgjidhjes së kontesteve jashtë sistemit gjyqësor, arbitrazhi tashmë është bërë i njohur botërisht.

Trendët e zhvillimit ekonomik e bëjnë të qartë se edhe Kosova dhe rajoni duhet të ndjekin këto zhvillime, andaj është shumë e nevojshme që edhe Kosova po ashtu edhe vendet e rajonit: Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina etj. të zhvillojnë dhe perfeksionojnë sistemin e arbitrazhit si dhe format e tjera alternative të zgjidhjes së kontesteve komerciale.

Bashkëpunimi rajonal dhe unifikimi gjyqësor në aspektin ndërkombëtar do të ndihmonte shumë në lehtësimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve tregtare me karakter ndërkombëtar.

Mungesa për një zgjidhje alternative të kontesteve komerciale paraqet një pengesë serioze për rritjen ekonomike në Kosovë, e sidomos kur kemi parasysh faktin se gjykatat e Kosovës ballafaqohen me një numër të madh të lëndëve të parashtruara vazhdimisht si dhe ato të grumbulluara prej vitesh, kjo na bënë të mundur të konkludojmë që zgjidhja alternative e kontesteve në Kosovë por edhe në rajon është një imperativ i kohës.

Literatura

1. BENNETT, STEVEN C. ESQ. ARBITRATION-essential concepts, NLP IP Company, American Lawer Media, 2002
2. Hetem,i Mehdi E Drejta Ndërkombëtare Tregtare-afariste (ligjerata të autorizuara), Prishtinë, 2007

3. Redfern, Alan and Hunter Martin Law and Practice of International Commercial Arbitration, Sweet & Maxwell London NU3 3PF, 2004
4. Jezdiq, Mihailo E Drejta Ndërkombëtare Private II, përkthyes Hamdi Vraniqi, Rilindja, Prishtinë, 1979
5. Michael, Moser J and Cheng, Teresa Y.W Hong Kong Arbitration, A User's Guide, KLUWER LAW INTERNATIONAL, 2004
6. Turner, Ray Arbitration Awards- A Practical Approach, Blackwell Publishing Ltd, 2005
7. Brestovci, Faik E Drejta E Procedurale Civile I, Universiteti i Prishtines, Prishtinë, 2004

Ligjet

8. UNCITRAL Model law on international commercial arbitration 1985 with amendments as adopted in 2006, united nations, Vienna, 2008
9. Ligji për arbitrazhin i Republikës së Kosovës, 26 janar 2007
10. Programi sistemi i përmbartimit të marrëveshjeve dhe vendimeve në Kosovë (SEAD), Raport dhe rekomandime për zhvillimin dhe zbatimin e suksesshëm dhe efektiv të sistemit për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, 30 prill 2010
11. Rregullat e arbitrazhit të Odës Ekonomike Ndërkombëtare

UNCITRAL Arbitration Rules (1976) (adopted by the General Assembly on
December

STATISTICAL ANALYSIS OF BINOMIAL TREES

A useful and very popular technique for pricing an option involves constructing a binomial tree . This is a diagram representing different possible paths that might be followed by the stock price over the life of an option . The underlying assumption is that the stock price follows a random walk . In each time step , it has a certain probability of moving up by a certain percentage amount and a certain probability of moving down by a certain percentage amount . In the limit , as the time step becomes smaller , this model leads to the log-normal assumption for stock prices that underlines the Black-Scholes model .

A ONE - STEP BINOMIAL MODEL

We can start considering a very simple situation. We take that a stock price is currently 50 Euro , and it's know that at the end of 4 months it will be either 35 Euro or 27 Euro . We are interested in valuing a call option to buy the stock for 34 Euro in 4 months . This option will have one of two values at the end of the 4 months . If the stock price turns out to be 35 Euro , the value of the option will be 1 Euro ; if the stock price turns out to be 27 Euro , the value of the option will be zero . This is illustrated in Figure 1 .



Figure . 1 , Stock price movements in relation with numerical example .

In the stock price move up from 34 Euro to 35 Euro , the shares is $22.\Delta$, and the total value of the portfolio is $35.\Delta-1$. If the stock price move down from 35 Euro to 27 Euro , the value of the shares is $27.\Delta$, the value of the option is zero , so that the total value of the portfolio is $27.\Delta$. The portfolio is risk-less if the value of Δ is chosen so that the final value of the portfolio is the same for both alternatives . This means that : $35.\Delta-1 = 27.\Delta$, and : $\Delta = 12,5\%$. A risk-less portfolio is therefore : Long – 12,5 % shares ; Short : 1 option . If the stock price moves up to 35 Euro , the value of portfolio is : $35.0,125-1 = 3,375$. If the stock price moves down to 27 Euro , the value of portfolio is : $27.0,125-0= 3,375$. Regardless of whether the stock

price moves up or down , the value of the portfolio is always 3,375 at the end of the life of the option .

GENERALIZATION OF THE PROBLEMS

We can generalize the argument a problems by considering a stock whose price is " S " and an option on the stock whose current price is " f ". We suppose that the option lasts for time " τ " and that during the life of the option the stock price can either move up from " S " to a new level " $S \cdot u$ ", where $u > 1$, or down from " S " to a new level " $S \cdot d$ ", where $d < 1$; this is illustrated in Figure . 2 .




Figure . 2 . Stock and option prices in a general one-step tree .

Now, we can give :

$$S^*u^*\Delta - f_u = S^*d^*\Delta - f_d \therefore \Delta = \frac{f_u - f_d}{S^*u - S^*d} \quad (1).$$

Equation (1) shows that Δ is the ratio of the change in the option price to the change in the stock price as we move between the nodes .

If we denote the risk-free interest rate by " r ", the present value of the portfolio is :

$$(S^*u^*\Delta - f_u)^* \exp(-r^*\tau) \quad *$$

The cost of setting up the portfolio is : $S^*\Delta - f$, and it follows that :

$$\begin{aligned} S^*\Delta - f &= (S^*u^*\Delta - f_u)^* \exp(-r^*\tau) \therefore \\ \therefore f &= S^*\Delta^*[1 - u^*\exp(-r^*\tau)] + f_u^* \exp(-r^*\tau) \end{aligned} \quad (2).$$

Connecting equations (1) and (2) we can find :

$$f = \exp(-r^*\tau)^*[p^*f_u + (1-p)^*f_d] \wedge p = \frac{\exp(r^*\tau) - d}{u - d} \quad (3).$$

TWO-STEP BINOMIAL TREES

We can extended the analysis to a two - step binomial tree such as that shown in Figure 3 . Now , we can generalize the case of two time steps by considering the situation in Figure 3 . The stock price is initially " S " . During each time step , it either moves up to " u " times its initial value or moves down to " d " times its initial value . The notation for the value of the option is shown on the tree . For example , after two up movements the value of the option is " f_{uu} " . We suppose

that the risk – free interest rate is “ r “ and the length of the time step is “ $\Delta\tau$ “ years

Because the length of a time step is now “ $\Delta\tau$ “ rather than “ τ “ , we became :

$$f = \exp(-r * \Delta\tau) * [p * f_u + (1 - p) * f_d] \wedge p[\exp(r * \Delta\tau) - d]/(u - d) *$$

Repeated application of this equation , gives :

$$\begin{aligned} f_u &= \exp(-r * \Delta\tau) * [p * f_{uu} + (1 - p) * f_{ud}] \wedge \\ f_d &= \exp(-r * \Delta\tau) * [p * f_{ud} + (1 - p) * f_{dd}] \wedge \\ f &= \exp(-r * \Delta\tau) * [p * f_u + (1 - p) * f_d] * \end{aligned} \quad (4).$$




Figure : 3 . Stock and option prices in general two – step tree :

Substituting from equations (4) we get :

$$f = \exp(-2 * r * \Delta\tau) * [p^2 * f_{uu} + 2 * p * (1 - p) * f_{ud} + (1 - p)^2 * f_{dd}] \quad (5).$$

This is consistent with the principle of risk-neutral valuation mentioned earlier . The variable p^2 , $2 * p * (1 - p)$ and $(1 - p)^2$ are the probabilities that the upper , middle ,

and lower final nodes will be reached . The option price is always equal to its expected payoff in a risk-neutral world discounted at the risk – free interest rate .

As we add more steps to the binomial tree , the risk – neutral valuation principle continues to hold . The option price is always equal to its expected payoff in a risk – neutral world discounted at the risk – free interest rate .

With condition , $\partial f / \partial p = 0$, we can find :

$$p_{extr} = \frac{f_{dd} - f_{ud}}{f_{uu} - 2 * f_{ud} + f_{dd}} \wedge f_{extr} = \exp(-2 * r * \Delta\tau) * \frac{f_{ud}^2 - f_{uu} * f_{dd}}{2 * f_{ud} - f_{uu} - f_{dd}} \quad (6)$$

Extreme value is maximum if it's either condition , $f_{uu} + f_{dd} < 2 * f_{ud}$, on contraire we have a minimal value for f_{extr} .

MATCHING VOLATILITY WITH " u " AND " d "

In practice , when constructing a binomial tree to represent the movements in a stock price , we choose the parameters " u " and " d " to match the volatility of the stock price . To see how this is done , we suppose that the expected return on a stock (in the real world) is " μ " and its volatility is " σ " . In Figure 4 . a) , it's shown that stock price movements over the first step of a to " $S * u$ " , or down to " $S * d$ " . The probability of an up movement (in the real world) is assumed to be " p^* " .

The expected stock price at the end of the first time step is " $S * \exp(\mu * \Delta\tau)$ " . On the tree the expected stock price at this time is :

$$p^* * S * u + (1 - p^*) * S * d \quad *$$

In order to match the expected return on the stock with the tree's parameters , we must therefore have :

$$p^* \cdot S \cdot u + (1 - p^*) \cdot S \cdot d = S \cdot \exp(\mu \cdot \Delta\tau) \therefore p^* = \frac{\exp(\mu \cdot \Delta\tau) - d}{u - d} \quad (7).$$




Figure 4 . Change in stock price in time $\Delta\tau$ in a) the real world , and b) the risk – neutral world .

We know that the volatility " σ " of a stock price is defined so that $\sigma\sqrt{\Delta\tau}$ is the standard deviation of the return on the stock price in a short period of time of length " $\Delta\tau$ ". Equivalently , the variance of the return is " $\sigma^2 \cdot \Delta\tau$ ". On the tree in Figure 4 a) the variance of the stock price return is :

$$p^* \cdot u^2 + (1 - p^*) \cdot d^2 - [p^* \cdot u + (1 - p^*) \cdot d]^2 \quad *.$$

In order to match the stock price volatility with the tree's parameters , we must therefore have :

$$p^* \cdot u^2 + (1 - p^*) \cdot d^2 - [p^* \cdot u + (1 - p^*) \cdot d]^2 = \sigma^2 \cdot \Delta\tau \quad (8).$$

Substituting from equation (7) into equation (8), we get:

$$\exp(\mu \cdot \Delta\tau) \cdot (u + d) - u \cdot d - \exp(2 \cdot \mu \cdot \Delta\tau) = \sigma^2 \cdot \Delta\tau \quad *$$

When terms in " $\Delta\tau^2$ " and higher powers of " $\Delta\tau$ " are ignored, one solution to this equation is:

$$u = \exp(\sigma \cdot \sqrt{\Delta\tau}) \wedge d = \exp(-\sigma \cdot \sqrt{\Delta\tau}) \quad (9).$$

Related of equations (7) and (9) we can find also:

$$p^* = \frac{\exp(\mu \cdot \Delta\tau) - \exp(-\sigma \cdot \sqrt{\Delta\tau})}{\exp(\sigma \cdot \sqrt{\Delta\tau}) - \exp(-\sigma \cdot \sqrt{\Delta\tau})} \quad (10).$$

Related of equation (10), in Figure 5, are give three curves with responsible values for expected value (μ) and for variance (σ).

The analysis shown that we can replace the tree in Figure 4, a) by the tree in Figure 4, b), where the probability of an up movement is " p ", and then behave as though the world is risk neutral. The variable " p " is given by know equation:

$$p = \frac{\exp(r \cdot \Delta\tau) - d}{u - d} \wedge p \cdot u^2 + (1 - p) \cdot d^2 - [p \cdot u + (1 - p) \cdot d]^2 = \exp(r \cdot \Delta\tau) \cdot (u + d) - u \cdot d - \exp(2 \cdot r \cdot \Delta\tau) \quad *$$




Figure 5. Function $p = p(\tau)$ for three cases :

1 - $(\mu=3/2, \sigma=2)$; 2 - $(\mu=3, \sigma=9/2)$; 3 - $(\mu=5, \sigma=6)$.

$$\begin{aligned}
 eq7 := p = & \frac{1}{2} \left(-\left(e^{(22\sqrt{\tau})} \right)^2 - \left(e^{(-22\sqrt{\tau})} \right)^2 + 2 e^{(22\sqrt{\tau})} e^{(-22\sqrt{\tau})} \right. \\
 & + \left(\left(e^{(22\sqrt{\tau})} \right)^4 - 2 \left(e^{(22\sqrt{\tau})} \right)^2 \left(e^{(-22\sqrt{\tau})} \right)^2 + \left(e^{(-22\sqrt{\tau})} \right)^4 \right. \\
 & - 4 \left(e^{(22\sqrt{\tau})} \right)^3 e^{(0.05\tau)} + 4 \left(e^{(22\sqrt{\tau})} \right)^2 e^{(0.05\tau)} e^{(-22\sqrt{\tau})} \\
 & + 4 \left(e^{(22\sqrt{\tau})} \right)^2 e^{(10\tau)} + 4 e^{(22\sqrt{\tau})} \left(e^{(-22\sqrt{\tau})} \right)^2 e^{(0.05\tau)} \\
 & - 8 e^{(22\sqrt{\tau})} e^{(-22\sqrt{\tau})} e^{(10\tau)} - 4 \left(e^{(-22\sqrt{\tau})} \right)^3 e^{(0.05\tau)} \\
 & \left. + 4 \left(e^{(-22\sqrt{\tau})} \right)^2 e^{(10\tau)} \right)^{1/2} / \left(\right. \\
 & \left. - \left(e^{(22\sqrt{\tau})} \right)^2 + 2 e^{(22\sqrt{\tau})} e^{(-22\sqrt{\tau})} - \left(e^{(-22\sqrt{\tau})} \right)^2 \right)
 \end{aligned}$$

..... (12);

Related of equation (11), in Figure 6 . is shown function dependence $p = p (\tau)$, where upper curve is done related of (13), and down curve related of (12).

When binomial trees used in practice , the life of the option is typically divided into 30 or more time steps . In each time step there is a binomial stock price movement . With 30 time steps there are 31 terminal stock prices and 2^{30} , or about 1 billion possible stock price paths are considered. The equations defining at

$$\begin{aligned}
 eq8 := p = & \frac{1}{2} \left(- \left(e^{(22\sqrt{\tau})} \right)^2 - \left(e^{(-22\sqrt{\tau})} \right)^2 + 2 e^{(22\sqrt{\tau})} e^{(-22\sqrt{\tau})} \right. \\
 & - \left(\left(e^{(22\sqrt{\tau})} \right)^4 - 2 \left(e^{(22\sqrt{\tau})} \right)^2 \left(e^{(-22\sqrt{\tau})} \right)^2 + \left(e^{(-22\sqrt{\tau})} \right)^4 \right. \\
 & - 4 \left(e^{(22\sqrt{\tau})} \right)^3 e^{(05\tau)} + 4 \left(e^{(22\sqrt{\tau})} \right)^2 e^{(05\tau)} e^{(-22\sqrt{\tau})} \\
 & + 4 \left(e^{(22\sqrt{\tau})} \right)^2 e^{(10\tau)} + 4 e^{(22\sqrt{\tau})} \left(e^{(-22\sqrt{\tau})} \right)^2 e^{(05\tau)} \\
 & - 8 e^{(22\sqrt{\tau})} e^{(-22\sqrt{\tau})} e^{(10\tau)} - 4 \left(e^{(-22\sqrt{\tau})} \right)^3 e^{(05\tau)} \\
 & \left. + 4 \left(e^{(-22\sqrt{\tau})} \right)^2 e^{(10\tau)} \right)^{1/2} / \left(\right. \\
 & \left. - \left(e^{(22\sqrt{\tau})} \right)^2 + 2 e^{(22\sqrt{\tau})} e^{(-22\sqrt{\tau})} - \left(e^{(-22\sqrt{\tau})} \right)^2 \right)
 \end{aligned}$$

equations (9) to (11) regardless of the *number of time steps* .

..... (13).




Figure 6 . Functional dependence , $p = p (\tau)$, for

$\mu = 10$, $\sigma = 22$ and for risk - free rate $r = 5\%$.

OPTIONS ON STOCKS PAYING A CONTINUOUS DIVIDEND YIELD

Consider a stock paying a know dividend yield at rate “ q ” . The total return from dividends and capital gains in a risk – neutral world is “ r ” . The dividends provide a return of “ q ” . Capital gains must therefore provide return of “ $r - q$ ” . In the stock starts at “ S ” , its expected value after one time step of length “ $\Delta\tau$ ” must be $S * \exp[(r - q) * \Delta\tau]$ • This means that should be :

$$p * S * u + (1 - p) * S * d = S * \exp[(r - q) * \Delta\tau] \therefore p = \frac{\exp[(r - q) * \Delta\tau]}{u - d} \quad (14).$$

As in the case of options on non – dividend – paying stocs , we match volatility by setting $u = \exp(\sigma * \sqrt{\Delta\tau})$ and $d = 1/u$ • This means that we can use before equations , except that we set $\mathcal{R} = \exp [(r - q) * \Delta\tau]$,




Figure 7. Function dependence $p = p(\tau)$, related of equation (14).

where is : 1 - ($r=5\%$, $q=2.5\%$, $\sigma=1.5$); 2 - ($r=5\%$, $q=2.5\%$, $\sigma=2.5$);

3 - ($r=5\%$, $q=2.5\%$, $\sigma=5$); 4 - ($r=5\%$, $q=2.5\%$, $(\sigma=10)/(\sigma=5)$).

Now, also we can find :

$$p = \frac{\exp[\tau * (r - q) + \sigma * \sqrt{\tau}] - 1}{\exp(2 * \sigma * \sqrt{\tau}) - 1} \quad (15).$$

SUMMARY

Here has provided a first look at the valuation of options on stocks and other assets. In the simple situation where movement in the price of a stock during the life of an option are governed by a one-step binomial tree, it is possible to set up a portfolio consisting of a stock option and the stock that is risk-less. In a world with no arbitrage opportunities, risk-less portfolios must earn the risk-free interest.

When stock price movements are governed by a multi-step binomial tree, we can treat each binomial step separately and work back from the end of the life of the option to the beginning to obtain the current value of the option.

Constructing binomial trees for valuing options on stock indices, currencies, and future contracts, is very important to doing so for valuing options on stocks.

LITERATURA :

- [1] Allen, R. D.G. : " *Mathematical Analysis for Economists* " , Macmillian Co. 1969 .
- [2] Baumol, W.J. : " *Economic Theory and Operations Analysis* " , Prentice - Hall, Englewood Cliffs, 1972 .
- [3] Boulding, K. E. : " *Economic Analysis* " , Volume I, Harper and Row, 1966 .
- [4] Chiang, A. : " *Fundamental Methods of Mathematical Economics* " , McGraw - Hill, 1967 .
- [5] Clarkson, G. P. E. : " *Managerial Economics* " , Penguin, 1968 .
- [6] Johnston, J. : " *Econometric Methods* " , McGraw - Hill Book Co. , New York, 1972 .
- [7] Malinvaud, E. : " *Methodes Statistiques de l'Ecometrie* " , DUNOD, Paris, 1964 .
- [8] Mood, A. M. , Graybill, F. A. : " *Introduction to the Theory of Statistics* " , McGraw - Hill, New York, 1963 .

World Customs Organization has developed conventions, standards and programs through which the customs administrations of Member States are able to offer their governments to improve trade facilitation combined with effective control. That is why our theme of research and elaboration will be **simplified customs procedures** as a basis for facilitating and increasing trade of our country abroad and also will be a key factor for its economic development.

Keywords: customs procedures, public finance, effects, Macedonia

Introduction

Project work is structurally divided into three parts. The first part concerns the meaning and types of simplified procedures in Macedonia, while the second covers the analysis of the challenges facing the agricultural sector in the application of simplified procedures. In it, through analysis of available data portraying the current situation in the use of simplified customs procedures. The third part presents the conclusion of the paper.

